

## INTERVISTË ME HASAN DËRMAKU

Prishtinë | Data: 20 dhjetor, 2023

Kohëzgjatja: 118 minuta

Të pranishëm:

- Hasan Dërmaku (i Intervistuari)
- Anita Susuri (Intervistuesja)
- Ana Morina (Kamera)

*Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:*

*() - komunikim emocional*

*{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste*

*Simbole të tjera në transkriptë:*

*[ ] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin*

*Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.*

## **Pjesa e Parë**

**Anita Susuri:** Zotëri Hasan, a bon ni prezantim t'shkurtë edhe diçka për kujtimet e juja t'para, për familjen?

**Hasan Dërmaku:** Quhem Hasan Dërmaku, i lindur me 28 janar 1945-ten në fshatin Shipashnicë komuna e Dardanës apo ish Kamenicë. Prej babës Hasanit i cili osht' vra në Luftën e Bujanocit në mbrojtjen e Kosovës Lindore me 12 shtator 1944. Kur ka shku në luftë baba im, nanës time, pranë nanës time kishte qenë edhe halla Sherife. Kish pasë lanë amanet, "Nëse vritem në luftë emrin nëse lind djalë lenja emnin Hasan, nëse lind çikë çkado boni". Fatmirësisht kom lind djalë e ma kanë lanë emrin e babës Hasan. Përndryshe shkurt krejt më thrrasin Can, me këtu me atje.

Prej nanës Zahide Korça-Dërmaku. Ajo osht' prej fshatit Gmicë. Kanë ardhë gjenerata e tretë, e katërt e nanës që kanë ardhë prej Korçës, kanë ardhë ortodoks. I pari i tyne e ka pasë emrin Ili, e kur kanë ardhë këtu s'kanë pasë, shkaku i martesave, na çoj Ilija u kthy mysliman edhe ka marrë emrin Ali. E prej Alisë deri te nana ime i katërti brez osht. Ata jetojnë, kanë jetu në Gmicë tash kanë ardhë në qytete.

**Anita Susuri:** A e dini arsyen pse kanë emigru në atë kohë?

**Hasan Dërmaku:** Po kanë emigru shkaku i ngatërresave, po, ngatërresave që kanë pasë kanë emigrua. Ni vëlla u nalë këtu në, afër Novoberdës. Ni vëlla ka shku atje në Gmicë. E ky vllavi që osht' afër Novoberdës, ky masi këtu ka pasë përreth ortodoks. Tash me siguri a kanë qenë shqiptarë apo serb nuk di. Ka kalu, nuk e ka ndrru fenë ka mbetë ortodoks. Dijnë nga pak shqip edhe e dijnë që janë prej Korçës po në të shumtën shërbehen në gjuhen serbe. A ky atje osht', në Gmicë osht' islamizu.

Nana, nana, plaka Maria, nana Ilies, Maria emrin ka dalë te djali i vet atje në Gmicë. Rastësisht ka vdekë atje. Dimër i madh, këta s'kanë pasë ku me çu. Prift s'ka pasë afër aty, kanë ra në Mëshidë e kanë marrë ni prift ortodoks për me vorros. Ata e kanë vorros i thojnë ni vend te Varret e Romakëve. Aty osht' e vorrosne. Qikjo osht' ajo.

**Anita Susuri:** M'tregut për babën e juj...

**Hasan Dërmaku:** Po.

**Anita Susuri:** A ju ka tregu ndonjëherë nana çfarë njeriu ka qenë?

**Hasan Dërmaku:** Po ka qenë njeri shumë punëtor, shumë i moralshëm, shumë mirëbërës. Për shembull vllavi i madh i babës tim, mixha Shaban s'ka pasë djem, s'ka pasë fëmi. Vllavi jem Nazifi, i vogël, në lulak, u ofru afër zjarrit ka ra në zjarr e baba jem prej ngushtimit prej vllavit t'vet as s'u ofru me hjekë derisa ka vrapu tjetër kush.

**Anita Susuri:** A keni qenë fëmi i vetëm, po mendoj...

**Hasan Dërmaku:** Jo, ne kemi qenë gjashtë vëllazër. Kemi pasë gjashtë vëllazër, unë ma i vogli Nazifi ma i madhi. Ai që u djegë pak gishtave. Unë ma i vogli jom edhe ni motër. Tash prej ktyne te tanët kanë vdekë e kemi mbetë vetëm dy. Ni vëlla osht' Hasim e ka, Hasimi edhe unë.

**Anita Susuri:** E për qat' betejën baba juj ku ka ra a dini diçka ma shumë lidhur me atë?

**Hasan Dërmaku:** Po ajo ka qenë lufta, ni front prej i thojnë te na Guri i Zi e deri në Bujanoc gati se në Preshevë. Po janë mundua po nuk ka qenë ushtri e rregullt po ashtu vullnetare. Këta nuk kanë pasë qaq përgatitje as profesionale as armë asi. Po si me thonë me ni gjoks kanë dëshiru ta mbrojnë. Po aty kanë shku edhe janë vra me babën tem tre vet. Dy prej fshatit Topanicë edhe babai im.

**Anita Susuri:** Ata kanë qenë antifashist a po?

**Hasan Dërmaku:** Po, po. Kanë qenë anti serb se ata s'kanë ditë për çka veç kanë qenë anti serb, anti jugosllav. Se kanë msu shumë gjatë kohës së Serbisë, Jugosllavisë së vjetër, s'kanë dashtë të mbesin nën Mbretërinë Jugosllave. Se këta s'kanë ditë çka domethonë antifashist e komunist, s'i kanë njoftë ato. Veç me ni fjalë kanë qenë antijugosllav, për qata.

**Anita Susuri:** E kështu me Ballin Kombëtar diçka nuk kanë qenë të mbrojtur?

**Hasan Dërmaku:** Ata krejt kanë qenë Balli Kombëtar, krejt kanë qenë Balli Kombëtar. Me flamurin e Ballit Kombëtar kanë luftu ata.

**Anita Susuri:** Pas vdekjes t'babës a është varros...

**Hasan Dërmaku:** Po, po. Baba osht' vra atje, me kerr... fshati Tërnoc, afër Bujanocit. E baba i qitij Nexhat, akademik Nexhat Dacit i ka pru te tret me kerr, me qerren e vet deri në fshat.

**Anita Susuri:** Kom dëgju që shpesh herë nuk kanë mujtë m'i...

**Hasan Dërmaku:** Po, po. Ka ndodhë që i kanë vorros aty e jo ai i ka pru. Se i kanë pru deri në Tërnoc në shpind e ato, bashkëluftëtarët. Aty i kanë ngarku në kerr të babës Nexhat Dacit, akademikut edhe i kanë pru deri në fshat. Kom për kujtim drrasat me të cilat...(emocionohet) Dërrasën me të cilën ka ardhë baba i vram. Osht' interesant mas ni viti a dy i kem pasë do mixhollar kanë qenë vetëm prej babës, ata ndërkohë e mbarun ni sofër prej atyne drrasave. Po.

Kemi ken' familje me migjollar e me krejt afër 30 anëtarë familjes. E nana ime kurrë nuk u ulë në atë sofër. Çka osht' ma me randësi, ma interesant, mu ni kohë edhe anëtarët e familjes s'kanë mujtë me m'thirrë në emër të babës. A nana deri jom kthy prej burgut të Lepogllavës kurrë s'më ka thirrë Hasan, kurrë. Vetëm bebë apo bebush. E kur pata ardhë, atëherë isha 27-28 vjet, atëherë s'pari herë m'ka thirrë në emër, Hasan. Qishtu.

**Anita Susuri:** E çfarë kujtime tjera keni prej fëmijërisë? U kanë kohë goxha e vështirë.

**Hasan Dërmaku:** Po ka qenë kohë e vështirë, ka qenë... ma së pari ishte, kur kom mujt me ditë kërkoshin tepricat. Ani s'kish diçka me hangër ta lypshin tepricat. Tjetër, merrshin tepricat me leje pa leje. Atëherë s'kishim me çka m'u ushqy. Si dilke pranvera, i thojshin nifar' si kokol, si nifar' bari. Dilshin e mblidhshin vajzat, ato hallat do t'vogla nëpër ara. Mujin mars a në prill. E përzijshin me miell, qata e hajshim si... vetëm me mbijetu. Vështirë ka qenë.

Tana '50-'51-ta ka qenë thatësi e madhe që... bukën e ndajshim kështu me pjesë me hangër e ngope s'u ngope s'ke pasë tjetër qata. Derisa fillun me shku, vëllazrit u rritën e me shku nëpër Banat me punu. Atje punojshin e blejshin misër në Banat e me trena e bijshin deri në Bujanoc e prej Bujanocit me kerr e bijshin në katund misrin. Qatëherë fillun, po.

**Anita Susuri:** A ju kujtohet diçka prej armëve që i kanë mbledhë?

**Hasan Dërmaku:** A?

**Anita Susuri:** Armët...

**Hasan Dërmaku:** A, po, po. Ka qenë aksioni i vitit '55-'56. E lypshin ni pushkë prej mixhës tem, vëllaut t'babës, plak ai. E kur dojshin me shku... në Hogosht ishte stacioni i policisë. Ai ka qenë plak. E për mos me rraf ata e morën, u vesh ni vëlla i jemi trash, emrin e ka pasë, vëllau i dytë Dilaver. Ai me shku atje e m'u paraqit në emër të axhës.

Po për fat në stacionin e policisë ka punu ni shok i vllavit, ni Can Rrahimi i thojshin. Hasan po Can i thojshin. Ai e ka shpëtu. Kur e shef flet me ata edhe e shpëton. Do të thotë që gjoja që këta s'kanë me

njoftë edhe e shpëton vëllaun pa hy në dajak. Përndryshe katër-pesë vet të fshatit, si pasojë e tyre kanë dekë shumë herët. E torturave.

**Anita Susuri:** E qysh ka qenë jeta në familje? A keni jetu prapë në bashkësi?

**Hasan Dërmaku:** Deri në '58-ten, deri 1958-ten kemi jetua në bashkësi familjare. 32 vet kemi qenë. Atëherë tani jemi nda. Na gjashtë vëllazërit kemi shku me ni shtëpi. Dy mixhollar që i kemi pasë vetëm prej njerks ata kanë shku me ni shpi. Ni mixh, axha i madh, Shabani, ka shku me nipin, me djaln e vëllaut që ka vdekë prej tifuzit kur u kthy prej frontit që ka qenë në Vojvodinë si partizan. Ai në '47-ten ka vdekë, e ata dy kanë shku bashkë. Na gjashtë vllazën kemi shku bashkë.

**Anita Susuri:** E organizimi i familjes qysh ka qenë? Sa keni qenë...

**Hasan Dërmaku:** Po. Po aty ka qenë ai axha Shaban ka qenë ma i vjetër. Ai osht' pytë për çdo gja. Çka ka thanë, çka u bo krejt këto. Po ka qenë tepër njeri i butë, njeri i mirë që s'u përzi fort. E ka ditë kush ka qenë lavërtar ai s'ju ka përzi. Kush shkon e kur i bjen, kush i ka rujt kafshhtë, e kur i bjen krejt i kemi pasë si nifar' vetë qeverisje aty, qashtu.

**Anita Susuri:** E shkolla?

**Hasan Dërmaku:** E shkollën fillore e kom kry katër klasë ka qenë në fshat aty, katër klasë. Ka qenë për fat e kemi pasë, e kom pasë mësus Sejdi Kryeziun, tash u shpall hero i popullit. Përndryshe ka qenë bashkëveprimtar i Metush Krasniqit. U dënua dhetë vjet burg, 15 vjet burg në proçesin Metush Krasniqi 1958-ten në Gjilan. E katër vjet i kom fillua në Hogosht. Të pestën, të gjashtën, të shtatën, të tetën i kom kry në tetë vjeçaren, i thojshin atëherë tetë vjeçare, në Hogosht. Se ka qenë, i thojshin, shkolla fillore, tetë vjeçare ka qenë ndame. E tash shkolla fillore po llogaritet tetë vjet e nantë, nisoj. Qashtu.

Prej shkollës fillore tani kom shkua vitin '61 jom regjistrua në gjimnaz në Gjilan. Po. Po aty kemi regjistru shkollën po është interesant ai ka, në kamë me ecë kështu trup mos me shku rrugës ka osht' asfalt sot. Atëherë s'ka pasë asfalt, po trup m'i ra rrugës. Rruga ka qenë gjashtë orë me udhëtu gjatë. E çdo... atëherë u mësu axhës edhe të shtunën, s'ka pasë pushim të shtunën.

E si u lëshojshim na prej msimit të shtunën shkojshim në katund e i përgaditshin ato kunatat, se ishin magjetore, kah gjashtë bukë. I thojshim mrume që i kanë sillë. Jo pogaçe po mrume. Ato i merrshim në shpind e vijshim në Gjilan e gjashtë ditë e kemi hangër bukën e ftoft deri në të shtunen tjetër kur kemi shku në shpi. E kështu me radhë.

**Anita Susuri:** Domethonë në Gjilan keni jetu?

**Hasan Dërmaku:** Po, kemi banu në privat, në shtëpia private. Po bukën e kemi bajtë rregullisht prej katundit qashtu. Bile në pranverë shpesh herë, koha e nxehtë, u myke buka. E kur merrshim me hangër, s'kishim qef me pa kah u zgatke myku i mshelshim sytë e qashtu, po.

**Anita Susuri:** Qysh ka qenë periudhën, domethonë, jeta aty në qytet tash prej vendit...

**Hasan Dërmaku:** Na, qyre, për neve s'pari herë me ardhë n'qytet unë kur jom ardhë m'u regjistru në gjimnaz. Çka domethonë. Për shembull, 15 vjeç kom ardhë s'pari herë në qytet. Kurrë pa ra në qytet. Kur erdhëm, na krejt s'dishim... shkum bashkë me ni shokun tim bashkë fshatar timin ni Ejupin. E pytëm njanin, "Ku osht' gjimnazi?" Shkum në gjimnaz. Po kur dolëm prej klasës të gjimnazit ku e kemi dhanë provimin pranues, kur dolëm në oborr apat u habitëm se s'dishim çka. Apat u duhke me pytë ka osht' me shku në qendër. Kur ram në qendër, kah osht' rruga me shku për Lepnicë. Se për Lepnicë e vazhdon drejt në Shipashnicë. Kemi qenë krejt të padalur.

Unë në shkollë t'mesme kur kom shku, me pantoll të zhgunit, të harrun. Jo me shku... edhe pse ishte vjeshta, vapë, ne kemi shku me të zhgunit. Me opanga me ato që kanë qenë të llastikit. Po ka qenë mjerim po u duhke m'i grah se s'kishte rrugë dalje tjetër. Atje toka ka qenë edhe pak ka qenë jo pjellore. Se fshati Shipashnicë gjindet, aty ku përfundon fshatrat që i thojnë të rrafshit edhe fillon Malësia e Kamenicës.

**Anita Susuri:** E ma vonë pastaj n'shkolle t'mesme sa keni qenë, a ka pasë kështu jetë kulturore sociale?

**Hasan Dërmaku:** Shumë pak ka pasë, shumë ka pasë pak. Se pak kemi qenë na. Krejt klasa e parë, e tretë, e katërt, krejt 19 vet kemi qenë, edhe ni vajzë ka qenë. E Gjilanit ajo. Se ajo vllaznit i ka pasë profesor. Brestovci u qujtë, Mehreme Brestovci. Vetëm ajo ka qenë në klasë me neve. Kështu që krejt e maj mend na si gjimnazista niherë kemi organizu ni dramë. Ata. Krejt mashkuj se s'ka pasë kush me ardhë prej femrave me lujt rol.

**Anita Susuri:** Çfarë drame ka qenë?

**Hasan Dërmaku:** Po ka qenë pak a shumë, titulli s'më kujtohet veç ka qenë diçka, ni autori francez e mu m'rajke me lujtë rolin e ni francezit, "Jo vapë, jo a ka ujë me pi", qito fjalë.

**Anita Susuri:** A ka pasë njerëz që kanë ardhë me pa?

**Hasan Dërmaku:** Po qysh jo, qysh jo. Po atëherë me nxanësa me krejt vijshin. Ka qenë veç me pa diçka t're. Filmi ka pasë po për neve ishte shtrejt s'mujshim me shku n'filma.

**Anita Susuri:** A keni shku najherë?

**Hasan Dërmaku:** Po kemi shku, jemi shku najherë kështu. Tana u organizojshin shkolla m'i çu n'film, a din. Atëherë për gjystë ma lirë e lëshojshin çmimin. E qatëherë na shkojshim rregullisht. Po ka ndodhë kështu kemi shkua.

**Anita Susuri:** Çfarë filma ka pasë atëherë?

**Hasan Dërmaku:** Po krejt kanë qenë t'thom t'vërtetën filma kauboj amerikan (qeshë).

**Anita Susuri:** Western.

**Hasan Dërmaku:** Po, po western.

**Anita Susuri:** A keni naj kujtim prej kur keni shku me pa këto filma?

**Hasan Dërmaku:** Po qysh jo. Osht' ai filmi dhjetë dollari i shpum. Serbisht e ka pasë titullin s'ka pasë atëherë përkthim. E qujshin *Probušenje dolara* [srb.: shpimi i dollarit] ku për shembull ata kaubojt e gjujn dollarin përpjetë ky me allti e çpon t'u ra. Ato kanë qenë filma t'hatashëm. Shumë kanë qenë që edhe sot m'i pa kisha shku m'i shiku. Se shumë kanë fantazi, shumë kanë pasë fantazi m'u çudit me pa. Po edhe sot, zaherë n'atë kohë m'kanë interesu, edhe sot m'interesojnë m'i pa ata filma.

**Anita Susuri:** Desha me ju pytë diçka lidhur me Gjilanin ndoshta e dini...

**Hasan Dërmaku:** Po.

**Anita Susuri:** Në Gjilan e di që ka qenë ni traditë për do festa, do Panagyri...

**Hasan Dërmaku:** Po.

**Anita Susuri:** A keni...

**Hasan Dërmaku:** Jo. Ka qenë i thojshin, kto kanë qenë u mblidhshin... në të vërtetë s'kanë qenë festa kombëtare për shqiptarë. Ata i qujshin Spasov serbisht. Shën Spasë. I thojshin Spasovdan, tashi janë dy, Spasovdan i vogli dhe i madhi. Turqisht ju thojshin panagyri. Se u bojke treg. A për ndryshe në aspektin kombëtar s'kanë pasë ato diçka. A ata i majshin festa, fetar kanë qenë. Dita e Shën Spasit, e qito i mbajshin ata.

**Anita Susuri:** E qysh u doke qyteti?

**Hasan Dërmaku:** Po u mblidhshin tregtarët. Ata shqiptarët shkojshin pak se s'e dijshin për çka, menoishin që është punë tregu jo ditë e shenjtë për ortodoksit.

**Anita Susuri:** Ato ditë tjera që kanë qenë si me maskime me... a ju kujtohet?

**Hasan Dërmaku:** Jo, jo s'ka pasë ashtu, s'ka pasë.

**Anita Susuri:** Okej. Desha me ju pytë pak për, domethonë, për aspektin kur keni fillu ndoshta me u inkuadru në aktivitete. Si ka lind krejt kjo?

**Hasan Dërmaku:** Po kqyre, ne sa ishim... kom qenë n'moshën thujse pesë-gjashtë vjet, shtatë-tetë vjet kur u lëshua ni kusheri prej burgut Metë Nuredin Dërmaku. Ai ka qenë i dënuar pesë vjet burg. Përndryshe ka qenë kryetar i Komunës së Dardanës, Kamenicës në atë kohë. Po 1947-ten, Gjon Sereçi, sekretar i NDSH<sup>1</sup>-së u ardhë në fshatin tonë edhe ka nejt gjashtë muj në bunkerin që e kanë pregadit fshatarët ne malin tonë. E ky si kryetar i komunës e ka ditë që osht' Gjon Sereçi aty edhe s'e ka lajmëru në pushtet a ka qenë kryetar komune.

Tani kur u zbulu Gjon Sereçi me shoktë e vet janë dënu... edhe ky osht' zbulu. E si të tillë edhe pse s'ka pasë kontakt me Gjon Sereçin, ky u dënu pesë vjet i ka majtë në gjygin ushtarak, po. I ka majtë ato. E kur u lëshu ai prej burgut qatëherë e kemi marrë vesh kush ka qenë Gjon Sereçi, qysh e çka kanë bo këto, NDSH-ja. Po masanej ka qenë, unë kam qenë në klasën e shtatë tetë vjeçare n'orën e gjuhës shqipe profesor Shaban Geci, profesor i gjuhës shqipe ni kohë. Por ai ishte i përndjekur politikisht, nuk e lejshin sigurimi shtetror i atëhershit.

Në atë kohë Shaban Geci e kish pasë "Jetën e Re", gazetën shkencore, "Jetën e Re". Na lexoj ni pjesë të romanit të Adem Demaçit, "Gjarpërinjtë e Gjakut". E qaty tana kom dëgju edhe për Bacën Adem në klasën e shtatë, tetë vjeçare në Hogosht. Kur na lexoj ni pjesë se jo komplet. Ni pjesë që ishte botu në "Jetën e Re", në klasën e shtatë kom qenë atëherë. E tana me to gjithmonë kemi ditë, Adem Demaçi, Adem Demaçi e qishtu.

## Pjesa e Dytë

**Anita Susuri:** Ju kur keni ardhë, a keni ardhë në Prishtinë?

**Hasan Dërmaku:** Po, po. Masi e kom kry gjimnazin kom punu dy vjet si arsimtar në shkollën fillore apo tetë vjeçare disi dy vjet, për me kriju rezerva për me ardhë me studiu. Vitin shkollor '66-'67 kem ardhë në Prishtinë e kom regjistru Fakultetin Filozofik, katedra e historisë, aty. Kemi qenë me shokë që jemi

<sup>1</sup> Lëvizja Nacionale Demokratike Shqiptare, e njohur me inicialet e saj si LNDSH ose NDSH, u bë një rezistencë thujse totale antikomuniste në Kosovë ndërmjet viteve 1945 dhe 1947.



njoftë prej gjimnazit. Këtu çka kemi njoftu prej Gjilanit kemi qenë shokë të njoftun edhe që kemi bashkëpunu e kemi nejt bashkë Skender Kastrati, Asllan Kastrati, Beshir Sherimi, Fadail Thaçi, Sabit Fazliu e shumë e shumë të tjerë.

Tana këtu ka qenë ni fat i madh i jemi që ndërkohë Skender Kastrati nëpërmjet vëllaut të vet Asllanit osht' njoftua me Osman Dumoshin në Prishtinë këtu. Tani unë nëpërmjet Skenderit jemi takua dhe jemi njoftu me Osman Dumoshin. Osman Dumoshi kishte qenë vëllau i Ismail Dumoshit. Ismail Dumoshi në atë kohë kishte qenë, atë kohë derisa ka vdekë, intelektual ma i madh që ka qenë, që ka pasë Kosova. Njeri intelektual, gojëambël, orator, tërhjekës, çdo kënd, çdo kujt m'i dalë ndihmë si Ismail Dumoshi, m'doket kanë me shku 50-60 vjet s'kanë me shëtitë rrugëve të Prishtinës sikur ai.

Tani ashtu kemi fillu në bisedë e sipër me Osmanin për çashtje politike na interesonte tana. Veç tana Ademi n'atë kohë ishte n'burg Adem Demaçi. Bisedojshim për jetën e Adem Demaçit. Tana këtu nëpërmjet Osman Dumoshit jemi njoftu me Selatin Novosellën, Ilaz Pirevën, Adil Pirevën, Xheladin Rekaliun, Afrim Loxhën e shumë të tjerë aty. Ndërkohë hajt bisedojshim... se n'atë kohë në, në korrik a në maj të qasaj kohe u majt këtu me nontë a dymbëdhjetë, simpoziumi për 500 vjetorin e vdekjes së Skënderbeut.

Ndërkohë më vonë u mbajtë plenumi i katërt i Komitetit Qendror të Serbisë ku ken' shumë arrogant ndaj çashtjes shqiptare. Aty në komitet, në qeverinë krahinore të asaj kohe u mbajtën mbledhje për ngritjen e statusit, avansimin e statusit të Kosovës në Federatën Jugosllave. Ku ma kryesorët ishin profesor Gazmend Zajmi, Ali Hadri, Fehmi Agani e shumë profesor e akademik tjerë. Po nuk shkoj përpara. Nuk lejke Serbia.

Atëherë na mendonim se si m'i dhanë përkrahje ni shtytje për ngritjen dhe avansimin e pozitës të Kosovës në atë kohë në Federatën Jugosllave. Bonëm bisedë për organizimin e demonstratave. Se atë vit ishte viti i demonstratave në Gjermani e në Francë e këto qytete Jugosllave Beograd e Zagreb. Atëherë edhe na u përgaditum. Po kjo për demonstrata që ishin zhvillu n'atë kohë në Francë ato kanë pasë krejt karakter social. Shkas e kanë pasë në Francë ku kanë kalu për skej Agjencisë Amerikane edhe në shenjë proteste që e bojshin amerikanët në Vietnam, i kanë thy dritaret.

Qaty kanë thy xhamat e zyret e Amerikan Express. E qaty ka fillu tana demonstrata e në krye të demonstratës franceze vendoset ky, i ka udhëheq demonstratën në Francë ky Daniel Fon, Daniel Cohn Bendit. Ndërkohë në Gjermani Rudi Dutschke<sup>2</sup> e kështu me radhë aty. Edhe në Beograd u majtën e kah mos. Edhe neve po ato u mbajtën në pranverë e ato kishin me karakter krejt social. E na e kishim karakterin politik.

<sup>2</sup> Alfred Willi Rudolf "Rudi" Dutschke (7 mars 1940 - 24 dhjetor 1979) ishte një sociolog dhe aktivist politik gjerman i cili, deri sa u plagos rëndë nga një vrasës në vitin 1968, ishte një figurë kryesore e studentëve socialistë. Unioni (SDS) në Gjermaninë Perëndimore dhe "opozita jashtëparlamentare" (APO) më e gjerë e atij vendi.

Ata na e shtytëm, bonëm përgatitje, ata kanë qenë tërësisht pa përgadit, rasisht i kanë fillu edhe me karakter social. Ndërsa na e kishim me karakter nacional. E për këto ndihmën ma të madhe, kuadri ideor kryesor për organizimin e demonstratës '68-tes ka qenë Ismail Dumoshi. E na që jemi dënu, unë, Hasan Dërmaku, Osman Dumoshi, Adil Pireva, Xheladin Rekalii, Ilaz Pireva, Skender Kastrati, na kemi qenë kuadër organizativ që kemi organizu. A me ekzekutu ka qenë rinia kosovare, populli, rinia, sidomos ajo studentore që ka qenë e flaktë, e edukune në pikëpamje kombëtare. E kështu e kemi organizu.

Mbledhja e parë edhe që u qit' ideja e parë, që u qit' aty në shtëpinë e Adil Pirevës në korrik të '68-ten, në korrik '68-ten në shtëpijën e Adil Pirevës. Aty ka qenë vetëm ai grupi i Osman Dumoshit. Ata që kanë qenë shok ma parë të njofshëm edhe që ni pjesë kishin qenë si kjo rinia e grupit të Adem Demaçit, ata. Ata kanë mbajtur në shtëpinë e Adil Pirevës për organizimin e demonstratave. Ndërkohë tani unë me Osmanin, në bisedë e sipër ai m'ka njoftu që qishtë kemi pru vendim për mbajtje të demonstratave. Tana kemi pajtu.

Tash Osmani m'ka njoftu mua, unë Skenderin, Skender Kastratin. Tana mbledhja tjetër u mbajtur në shtëpinë e më vonë Xheladin Rekalit. Masanej kom ardhë kah muji tetor ashtu në Prishtinë në privat e jom taku me Osmanin edhe kena pru... me Osmanin kemi bisedu te ky Hoteli Union që osht' tash. Përpara ka qenë Union i kanë thanë, në qendër që osht' tash. Ka thanë, "Do të veprojmë në dy grupe".

Osman Dumoshi me shoktë e vet ka pasë organizimin e shkollave të mesme, qytetarët këtu se ata ishin prishtinas gati krejt edhe Podujevën. E unë me Skender Kastratin kemi pasë studentët e fakulteteve, të shkollës të lartë edhe Gjilanin edhe Ferizajin me organizu. Tash mbas organizimeve që kemi bo, por gjithmonë, gjithmonë udhërrëfyes apo si me thanë, timonjer të lëvizjes të organizimit, të demonstratave ka qenë Ismail Dumoshi. Ai ia ka dhanë kahjen kur duhet, qysh duhet, si duhet.

Bile me 20 gusht intervenun trupat ruse në Çekosllovakia dhe e shujtën atë pranverën e Pragës, atëherë Ismail Dumoshi, jo nëpërmjet meje, nëpërmjet Osmanit thotë, "Ndalni mos u ngutni, e shohim çka po bohet". Se atëherë edhe Jugosllavia filloj m'u frikësu masi rusët intervenun në Çekosllovakia mos po intervenojnë edhe në Jugosllavi.

Atëherë ky Osmani ka qenë shumë, ka qenë edhe ky si vllavi i vet qesharak. Tha, "Kqyr Hasan", tha, "se mos po mundohemi me luftu kundër hijenës serbe e p'e bijmë ariun polar rus" a din, "p'e lajmë niherë po pushojmë te kqyrim çka po bohet". Mbas nja ni muj dite, Ismail Dumoshi me shoktë e vet, i cili ka pasë shokë t'vet t'besushëm. Se Ismail Dumoshi n'atë kohë ka qenë anëtarë i Komitetit Komunal të Prishtinës. Po ka pasë shok t'besushëm. Po ka pasë njerëz edhe në komitetin krahinor edhe udhëheqës krahinor që kanë kontaktu me Ismail Dumoshin. Se ka qenë njeri i besës, njeri i fjalës.

Na thojnë, 'Mas ni muji mundeni me vazhdu organizimin se lajmet që janë marrë, s'ka rrezik për intervenim në Jugosllavi të Rusisë, Bashkimit Sovjetik'. Po ato mendime Ismail Dumoshi i ka marrë

edhe nga udhëheqësia e Shqipërisë. Se Ismail Dumoshi përveç që ka pasë lidhje me organet, me njerëz që kanë qenë në rendet kyçe në udhëheqësinë e Kosovës ka pasë lidhje edhe me Shqipëri.

Që ka pasë Ismail Dumoshi lidhje edhe me Shqipërinë, me udhëheqësinë shqiptare e vërteton në intervistë e Ramiz Alisë pas lufte që ka dhanë. Thotë, “Për ngjarjet e ‘68-tës rregullisht çdo ditë kemi qenë të informuar si po shkon situata”. Krejt këto janë shku nëpërmjet Ismail Dumoshit edhe shokve t’tij. Atë ne nuk e dijmë. As Osmani s’e din që ka qenë vëllau i tij e le’ mo unë që kam qenë shok i Osmanit. Përndryshe ato krejt...

U vendosën, kishin vendos te shpija e Osman Dumoshit me 16 nëndor m’u mbajtë mbledhja grupi i Osmanit. Në qat’ grup m’kanë ftu edhe mu. Unë me marrë pjesë si grup, në emër, përfaqësues i grupit tim. Po unë kisha me shku në Gjilan me shku me këqyrë s’i po zhvillohet situata. Aty ishin të angazhuan për organizimin e demonstratave në Gjilan Asllan Kastrati edhe Beqir Qerimi me Minivere Kastratin edhe Fetije Bajramin.

E thashë, “Osman unë s’kom, se ka me shku për Gjilan”, atëherë Osmani m’tha mu, “Lej me shkrim çka ke organizu, ku ke organizu, cilat fakultete, cilat katedra”, thashë, “Osman, çdo fakultet, çdo katedër, çdo vit krejt janë t’organizun”. E kom dhanë, aty shkrun 165 vetë. Për fat asnja nuk është me emër. Se për shembull viti i parë, qiky, qiky. I dyti Shqipja e këto... po asnjë s’e kom cekë me emër veç 165 janë organizatorë tana ata çka i kanë ata t’vetit.

Ka thanë, “Edhe propozimet”. Në atë letër unë i kom shkru, “Kishte me qenë mirë demonstrata m’u zhvillu me 26 nëntor, para se me shku studentët m’u shpërngul nëpër shpija”. Kom propozua që, Adil Pireva pat’ fillu me punu si gazetar, direkt mos me, drejtpërdrejt mos me marrë pjesë në demonstrata po me nejt si anash. Masanej mos me ra ai n’burg po nëpërmjet shkrimit në gazetë gjithë me dalë në mbrojtje të demonstruesve edhe të rolit të demonstratës.

Po ajo letër tana, atë ditë që u bo n’mramje me 28, me 27 kur kanë qit’ kështu me ujë e kanë lagë Osman Dumoshin ajo letër u ngjit për tesha të Osmanit. Kur u shku Osmani në mramje në shpi, ai s’e ka pa. I ka hjekë tjerat ajo ka mbetë. Osmani tha, “Me 28 nëntor në mëngjes e kanë arrestu”. Kur e kanë pru e kanë këqyrë letrën, qat’ letër e kanë marrë. Qishtu.

**Anita Susuri:** E qysh ka qenë qat’ ditë?

**Hasan Dërmaku:** E kështu, tash na me 23-tin, me 23-tin nëntor 1968 jemi taku në shtëpinë e Selatin Novosellës. Në atë shtëpi në emër t’grupit tonë kam marrë vetëm unë pjesë, Osmani ka marrë pjesë me shokë. Aty u vendos Skender Muçolli edhe Ilaz Pireva m’i shkru afishet se kanë qenë në Fakultetin Teknik me shkronja teknike. Adil Pireva me përgadit referatin që lexohet aty. Referati m’u bo n’dy kopje. Ni kopje me lexu Osman Dumoshi a unë me pasë kopjen teme në xhep.

Nëse pengohet Osmani, plagoset a vritet, se kështu ndodhi në Gjermani me Rudi Dutschke e plagosën rand edhe si pasojë e asaj dikur vdiq. Po. E tani ka pasë nja dy kopje. Tana u vendos që Ilaz Pireva edhe Selatin... aty u vendos Osmani me 27 masdite me qenë, me rujt në mes tash ku osht' biblioteka popullore aty. Në mes Fakultetit Ekonomik edhe Fakultetit Filozofik ai me kujdestaru, me kqyrë çka po ndodhë.

Unë kom pasë për detyrë me nejt në oborr të Fakultetit Filozofik me shiqu edhe me prit kur t'vijne Selatini edhe kur t'i bijnë me pajton afisheet, flamurin edhe parollat. Parolla se afishe s'ka pasë atëherë. Në atë mbledhje te Selatin Novosella Selatini e ka propozua që demonstrata, demonstratat në Podujevë, në Gjilan edhe në Ferizaj të mbahen paradite. Ma së voni nga ora dy. E për Ferizaj ka qenë, kanë qenë shoktë tanë. Unë, Skender Kastrati, Asllan Kastrati, Beqir Qerimi, Ali Mehmeti edhe ky kusherini i tina Jakup Mehmeti.

Ali Mehmeti dhe Jakup Mehmeti kanë qenë ata organizatorët kryesor për organizimin e demonstratës në Ferizaj. Aty Selatin Novosella ka propozua që demonstrata jo me 26-tin po të mbahet me 27-tin edhe ata pesë minuta në 04:00, 16:00, 04:00 masdite. Unë aty kom qenë në oborrin e Fakultetit Filozofik, aty. Por, pajtoni me Selatinin edhe me Ilazin ka ardhën dhjetë minuta ma herët, para, po.

Po në qat' kohë unë ku ka tash ku osht' kjo bre si me thanë, kur del te radiostacionit po ma knej, ku del policia ku del n'rrugën kryesore që doket fakulteti. Në qat' moment dhetë minuta e kom pa kur janë dalë policia krejt si ret e zeza, a din, me blloku. Kur u ardhë Selatini i kom thanë, "Selatin, hajde ma shpejt se do t'bllokohem". Veç e dita, filloj, te studentët filloj nifar', ni lloj paniku. Kur i panë këta policinë, krejt policinë, krejt me shlema filloj pak ni panikë.

Atëherë ma shpejt s'e kom pritë unë m'u bo pesë në 04:00 po kom fillu demonstratën dymbëdhjetë në 04:00, shtatë minuta përpara. Unë e kom fillu. E kom marrë flamurin, s'e kom pasë për detyrë unë me marrë flamurin ose m'i pri. Po kur e pashë që don m'u blloku e kom marrë flamurin i pari kom pri, tana kanë ardhë studentët mas meje të tjerët. Kur kemi ra n'rrugën kryesore i pari jom ndesh me policinë.

Ata serbisht folshin, në të shumtën kanë qenë policë serbë. "Kthehu te mas", unë, "Jo". Aty jom kacafyt me policinë s'pari. Njënit i kom mshu me shtizë të flamurit. Atëherë m'u kanë lëshu tre-katër policë me pendreka trupit e kresë e krejt. Mu m'kanë alivanosë. M'ka shku gjaku për goje edhe prej hunde edhe jom rruzu aty. Studentët m'kanë ngreh zhag, m'kanë qit' në trotuar m'kanë lanë aty. Ata kanë vazhdu kah qyteti.

Unë, unë tanë demonstratën dhetë minuta e mbaj ndërmend. Ka zgjatë katër orë, a mu kurgjo s'më kujtohet. Se kom qenë i alivanosur. Pas këtij rasti, pas nja dhetë-15 minuta kanë ardhë nja dy-tre shokë me m'kapë për krah edhe kemi ecë me ta ni kohë pak diçka. Jom shtrëngu pak deri në momentin kur kanë gju ata me armë osht' vra Murat Mehmeti. Osht' plagosë Skender Muçolli.

Skender Muçolli m’thotë mu ditën e gjykimit kur kishim pauzë aty, thotë, “Ti Hasan e ke nalë ni kerr me dhunë se s’dojke m’u nalë ai, i ke dalë përpara e na ke shti n’kerr mu edhe Murat Mehmetin. Ata t’vran a mu të plagost edhe jemi nisë për spital”, a mu as s’më kujtohet ai rast. Ndërkohë Adil Pireva m’ka pa mu që psiqikisht edhe fizikisht i rraskapitur m’ka marrë përkrahësh m’ka çu në shtëpinë e Selatin Novosellës, që ka qenë ma së afërmi prej qytetit.

Kur kemi shku gjatë rrugës aty, Adil Pireva e kish pa në brez temin alltinë e tina. Beretkë, të Adil Pirevës. Që e kanë pasë lanë në dugojën e Sabri Novosellës. Në rast nevoje gjoja se me përdorë edhe ato. E tash unë nuk e di kah m’ka ardhë. Adili m’pytë a as une nuk e di kah m’ka ardhë mu alltija e Adil Pirevës në brez timin. E shkum na te shpija e Selatin Novosellës. Ai Adili e ka marrë alltinë prej meje edhe m’ka lanë mu pak me pushu.

Unë si kom pushu pak, nja gjysë ore, kur çohna Adil Pireva s’osht’ aty as kërkush prej familjes. Jam nisë unë prap kah ora 08:00, para 08:00 e diçka, jom nisë me ra apet te demonstruesit. Apet erdha n’veti. Kur kom ra para teatrit aty studenta s’kom pa aty veç ni kësi polic. Si m’kanë pa ata, serbisht m’u kanë përgjegjë, “Ende po kërkon demonstrues ti a?” M’u kanë lëshu edhe aty m’kanë rrah. Sa m’kanë rrah nuk e di veç m’kujtohet qysh jom rrëzu në pllato.

Masanej qashtu jom çu zhagas jom dalë në Rrugën Ramiz Sadiku. Aty jom taku m’kanë taku Bedri Novosella edhe Selatin Novosella. Përkrah m’kanë marrë m’kanë çu në shtëpinë e tyre. Selatini thotë që, “E ke pi ni kafe”, mu s’më kujtohet. Edhe kemi ra me pushu. Bile kemi ra unë edhe Selatini me ni krevet. Në mëngjes kur po i shoh po flasin milicia po hallakasin shtëpijave, shtëpijave a din. E unë për mos me m’nxan aty si i huj në banesë të Selainit, u çova dola jashtë e po du me shku drejt shtëpisë të Osman Dumoshit.

U takova në vllavin e Selatinit, Sabri Novosellën. “Hasan ku je nisë”, thashë, “Du me shku”, thashë, “me kqyrë çka u bo me Osmanin”, “Jo”, tha, “Osmanin e kanë burgosë para gjysë ore”. Tana u nisa me ra kah ish Rilindja, tash osht’ Ministria e Diasporës është aty. Aty ka qenë Rilindja aty u botu. Po aty Rilindja u blloku me tanka. Si prej anës së epërme si prej anës së poshtme. E rujshin tankat edhe ushtria.

Atëherë kom hi tash kah sokaku i ngushtë, rruga e ngushtë kah Shkolla “Elena Gjika” kom dalë në rrugën kryesore. Aty jom taku në Asllan Kastratin dhe Isa Kastratin. Kemi bisedu aty ni copë herë edhe kemi vendosë me shku me lypë ku osht’ shpija e Murat Mehmetit. Duke menduar na se tash bohet vorrimi dikur. Kur kemi shku në shtëpinë e Murat Mehmetit, plot shtëpia ka qenë, oda njerëz.

Na po bojmë pyetje, qysh? Tek? Kur do t’bahet vorrimi? “Jo”, tha, “e kena vorros naten”, tha, “Muratin. Na kanë pru policia dhe kanë pru urdhër, ‘A po vorrosni ju vet edhe e dini ku e vorrosni apo e vorrosim na që ma kurrë s’e dini ku osht’ i vorrost?’”. Tana ata patjetër me shtatë-tetë vet aty do kusheri, do mixhollar e kanë vorros Murat Mehmetin. Qaty.

**Anita Susuri:** E ju pastaj a shku dikund m'u kontrollu?

**Hasan Dërmaku:** E jo tash unë prej atyhit unë çka me bo, unë edhe Isa Kastrati vendosëm m'i shtyp do afishe m'i shpërnda për me bojkotu mësimin deri të lirohen këta të burgosurit. Se i patën burgosë do studenta, po. Po s'mujshim me çka, s'ka pasë me çka. E Isa Kastrati me ni bashkëfshatar t'vetin Veli Beqirin e kishin siguru ni maqinë, shtypshkronjë që ka qenë tipi i vjetër. Na ka marrë unë dhe Isa Kastratin jena shku në Breg të Diellit atje. Viza-vizë me këtë që osht' halla e sporteve atje nalt.

Ka qenë shtëpinë e ka pasë ni ky Sylejman Ahmetaj prej fshatit Hogosht. Jemi shku në shtëpi të tina, ai na ka pranë. Letrat i kemi shtypë ato afisheet na ka siguru Veli Beqiri. Atëherë na gjithë natën kemi shtypë afishe që t'nesrit m'i marrë m'i shpërnda në Ferizaj në Gjilan m'i marrë m'i çu t'nesrit. Na i morëm i shtypëm ato edhe ia dham Miniverës dhe Fetijes. Se erdhën ato prej Gjilanit me marrë pjesë në demonstrata masdite në Prishtinë. M'i çu për atje m'i shpërnda.

I kanë marrë ato dhe ju thashë me porosi që, "Kur t'shkoni në Gjilan ju mos t'asi se po bini n'sy po jepnja djalit t'vllaut tem Xhavit Dërmakut edhe ai me shoktë e vet le t'i shpërndajnë". Ata e kanë shpërnda ni pjesë ku u bo thirrje që të bojkotohet mësimi me ato afishe derisa të lirohen të burgosurit politik. Tani qat' ditë t'nesrit ka ardhë vëllavi jem prej fshatit Hasimi.

U taku shoktë e mi që kanë qenë organizator të grupit të historisë Anton Sopi dhe Sefedin Balaj. Ka pytë për mu, "Ku osht'?" "Këtu pari, po s'e dijmë ku", "Nëse e gjeni këtu te Hoteli Union qaty e pres e takohemi". Unë shkova te Hoteli Union u takum aty. Po thotë, "A din çka, me urdhërin e Metush Krasniqit kom ardhë edhe e kom siguru ni strehimore aty n'katun te ni Ramadan Adil Dërmaku që ju me ardhë ti edhe Skender Kastrati m'u strehu për ni kohë t'gjatë".

Po qat' ditë veç dëgjova që osht' burgosë Skender Kastrati. Thashë, "Vllavi jem Skenderi osht' burgosë a une po insistoj diqysh mujsha me ardhë po ta kqyri". Se me shku n'kamë s'ma merrke menja, me shku kështu me autobus këta kontrollojshin. Metush Krasniqin, se ish i burgosun politik. Këta unë e kom pasë gjatë tanë kohës si këshilltar. Ndërsa Osman Dumoshin e ka pasë si këshilltar Kadri Halimin. E Selatin Novosella masanej ka pasë si këshilltar Hyrije Hanën. Se kta ishin te tanë t'burgosur politikë që kishin përvojë në çashtje të organizimit.

Po vëllau kthehet shkon për katun. Unë kthehem shkoj buj atë natë po atë vend ku i kom shtyp afisheet. T'nesrit shëtis nëpër qytet edhe mbaj mend, pata shiku ni autobus prej stacionit ku osht' tregu tash ka qenë stacion i autobusave. Ka qenë ni autobus që e qitke kordonin brenda me mujtë me hy atje e me mujtë m'i qit' kamtë aty e me nejt komod. E bojsha mend me qata me shku deri dikund me dalë se s'ke mujtë me dalë prej Prishtinës.

Kur shkova aty e takova ni shok të Hodonovcit ni Beqir Bashën. Ai tha, "Ku je Hasan Dërmaku?" Ai si ma ka përmend mu Hasan Dërmaku ata milicia meniherë sytë kah unë edhe po më përcjellshin.

Thashë, “Dola”, thashë, “po shkoj kah qyteti”. Kur jemi ardhë te Hoteli Union ai zazerë ka pasë këtë toki-vokin. Selim Brosha punëtor në Sigurimin Shtetnor të Gjilanit. Aty jemi taku me to.

Jemi taku me Selim Broshën edhe po m’thotë, “Hasan e kom ni punë me ty po hyjmë qitu në hotel p’e pijmë kah ni kafe”. Hinëm aty. Po thotë, “Kom urdhër me të arrestu”, “Për çka me më arresu?” Tha, “Dyshohet se je ndër organizatorët kryesor të demonstratave”, p’i thom unë, “Keq qenke i informun”. Jo, po, jo.

Po unë në xhemperin që ka pasë ni jakë të kthyne i pata shti do afishe, t’i kom kah t’shkoj m’i shkepë. Ai ishte në atë anë të tavolinës unë në këtë anë të tavolinës. Unë niherë po flas me fjalë t’buta derisa i nxorra ato kadale prej aty edhe prej kësaj e i lëshova n’tokë. Tani i thashë, “Jo bre Selim kurgjo s’kom bo”, bohet s’bohet. “M’u çu”, thashë, “Nuk çohna”.

Ai thirri me toki-voki milicinë. Erdhën dy kompanjolla njona te dera njona te dritaret e bllokun. “Çu”. E urdhëroj policinë hinën policia po m’thojnë, “Durtë lartë”, a din serbisht “*Ruke u vis*” “*Ne çujem za to*, Nuk ndi për atë”. M’kapën me zor m’i vun prangat n’dorë m’shtinën atë kompanjollën e drejt në polici me Selim Broshën. M’dorëzoi aty në...

**Anita Susuri:** Në Prishtinë?

**Hasan Dërmaku:** Po në Prishtinë. Ai u kthy. Atë natë m’kanë lanë t’qetë me pushu se edhe ata vet kishin qenë zazer t’lodhur. Tani ka fillu marrja n’pytje. Po çka osht’ ma kryesorja që gjatë hetimeve, gjatë gjykimit krejt me ni mënyrë u ndi, u ndi sikurse instruksionet e Ismail Dumoshit se qysh m’u sillë gjatë hetimeve, çka me folë, mos me pranë çka osht’ diçka armiqësore.

Pse? Se harrova me cekë. Referatin që e ka pregaditë Adil Pireva ka qenë pak ekstrem. Që ditën e gjykimit për neve kishte me qenë shumë i rrezikshëm, ish marrë si inkriuues shumë. E ka korigju Ismail Dumoshi. Po qaq e ka korigju në mënyrë profesionale, në mënyrë diplomatike që kurgjo s’ke mujtë me vrejt që ka diçka armiqësore.

Sot e kësaj dite ka shumë njerëz që pyesin, “Qysh u pregadit aq mirë?”. Kur shkova aty ka qenë ai, po i harroj, kryeshef tha, “Shkruje ni biografi qitu kah e qysh e tek”. Unë e shkrova ata kur p’e merr ai ata që e kish marrë të Osman Dumoshit letrën edhe po i krahason, a din, shkrimin. Thotë, “A i ke dhanë naj letër Osman Dumoshit ti?” Thashë, “Jo”, “E qiky i kujna osht’?” Thashë, “E jemja”. U zu që letra jeme, s’kisha ku me shku ma. Qaty.

Aty ka qenë si për shembull unë kom pasë siç thashë edhe ma parë Gjilanin edhe Ferizajin. Po me instruksionet e Metush Krasniqit, Mumin Kastratin e pat’ caktu, ish i burgosur politik i fshatit Hogosht me përcjellë gjendjen para bërjes së demonstratave. Se a po ka diçka a po ndihet, a po hetohet, a po

zbulohet diçka. A për Kamenicë unë shkova, e kom pasë Mehmet Rudullin, drejtor i gjimnazit të Kamenicës.

Kur shkova në Kamenicë ai kishte qenë në mbledhje të komitetit. Kur dul prej komitetit po i thom e kom ni punë qishtu qishtu. Ai u habit tha, “A e pe prej kujt dola? Prej Komitetit Komunal”, thashë, “E kom urdhër prej Metush Krasniqit me ty me bisedu për këtë çashtje”, “A mirë”. Kemi shku në drejtori të gjimnazit edhe kemi bisedu. “E ki për detyrë me përcjellë a po ndëgjohet fjala, a po zbulohet dikush, a po thotë dikush edhe me shku ditën e shtunë në Gjilan kur të mbahet demonstrata me përcjellë si po zhvillohet”. Ai pranoj.

Kështu që në ni mënyrë edhe pse kemi qenë të ri po me instruksionet e Metush Krasniqit kemi ditë m’i organizu. Edhe organizimin po edhe me përcjellë situatën rreth organizimit me njerëz të besueshëm që kërkush nuk ka dyshu që ata bojnë ni vepër të tillë. Po. E ky ishte Mumin Kastrati ishte i dënun po ky miqtë i kishte në Përlepnice. Përlepnica ish gati ngjit me Gjilan. Ka mujtë me thanë që te miqtë e me marrë vesh si po silllet situata. Qashtu ka shku.

### Pjesa e Tretë

**Anita Susuri:** E për burgun që fillut me tregu sa, a kanë zgjatë shumë hetimet?

**Hasan Dërmaku:** Kanë qenë nja... po kqyre, na jemi burgosë në dhjetor, qishtu në dhjetor, e në prill ka fillu procesi gjyqësor. Jemi dënu unë, Osman Dumoshi... Osman Dumoshi i pari, unë i dyti, Selatin Novosella, Adil Pireva me kah pesë vjet burg. Skender Kastrati edhe këta tjerë Afrim Loxha me katër vjet, me tri vjet edhe me dy vjet. Ndërkohë gjyqi suprem masanej na ka hjekë nga ni vjet çka kemi qenë katër, pesë kemi ra në katër sa kemi qenë aty. Tre kanë ra në dy, katër tre, e tre në dy qishtu.

**Anita Susuri:** Ju prej pesëve në katër [vite burg]?

**Hasan Dërmaku:** Po, prej pesve në katër. Po na ka muji maj unë, mua, Selatin, Osman Dumoshin, Adil Pirevën edhe Selatin Novosellën të lidhur me pranga me tren këtu e deri në Nish na kanë çu në burg në kapedon, shtëpinë ndëshkimore të Nishit. Aty kemi fillu me vuajt dënimin. Ni muj ditë kemi qenë si thonë në atë dhomën provuese me t’çu te mjeku, te psikologu. Kur jemi dalë aty e kemi gjetë Ramadan Shalën, ni i burgosun poliitk i grupit të Adem Demaçit. Me ta kemi nejtë gjatë.

Ndërkohë ata e bonën me ndrru vendet se puna kishte, puna ma e randë. Sidomos për Adil Pirevën. E çun aty ku bohet terja, terja e ktyne pjesëve të kadave [vaskave], bojlerëve. Aty ishte temperaturë e padurueshme. Adili e pat’ refuzu e patën çu në qeli. Ndërkohë edhe Selatinin i kishin pasë thanë me lajmru në raport për me çu n’qeli. Aty në qeli... e atëherë unë, Osmani dhe Selatini vendosëm me organizu grevën në Burg të Nishit.



Aty e organizum grevën. Na bashkangjitën edhe këta tjetër që ishin për vepra tjera. Se ni Qazim Kabashi i Gjyakovcit, Sherë Berisha i Kaçanikit, ni Ukë i Vuçiternës, plot, plot. Prej atyhit na shpërndatjen. Na çun nëpër qelia. Qelia ish beton. Unë si shkova aty, i ri. E datha ni këpucë e vnova në kokë edhe njo te kryt edhe m'kish pasë zan gjumi qashtu në beton. Kur kah dreka e prunën bukën, unë bukën s'e mora. Ishte e nanta ditë e grevës.

Kur mas dreke kah ora tre qishtu a katër e çelën derën. "Hajde ec, mathu edhe ec". Kur dal m'çun te porta kryesore. Aty e pashë atë sandekën e drunit që e kishim na, aty te dera. Kur e pashë edhe Shaip Berishën edhe Ukën prej komunës së Vuçiternës. Na hypën në kompanjollë na tre edhe ata katër policë. U nisën. Na s'e dishim kah po na çojnë. Kur shkum në mramje në terr të akshamit u kthym në Mitrovicën e Sremit në burg aty. Bujtëm aty ni natë, e bonëm ni natë edhe aty e prunën bukën, s'e hongrëm. U bo veç e dheta ditë.

Na nisën tani hajt. S'e dishim ku po shkojmë se e mbyllt krejt ajo. Kur shkum kur p'e shohim aty Kapedan, a dinë Burgu i Stara Gradishka në Kroaci. Aty, Ferat Uka, e lan Ferat Ukën aty e mu e Shaip Berishën prapë përpjetë. Ku me na çu, t'u ra terri i mramjes, në mramje në Lepogllavë. Përte Zagrebit, përte Varazdinit. Tana e kom kalu pjesën ma t'madhe atje.

**Anita Susuri:** E qysh ka qenë atje burgu? A keni punu a?

**Hasan Dërmaku:** Kena punu, po, po, tetë orë kemi qenë t'obligun me punu simbas rendit shtëpiak. E çka osht' ma kryesorja kur kemi dalë ditën e gjykimit na këtu tash me siguri Ismail Dumoshi përcjelltë fjaltë. S'e di s'më ka thanë këta askush. Po ka qenë ni Qerim Gashi që ka punu në puntë e brendshme në Prishtinë që e ka njoftu Osmanin që çka do t'jetë armiqësore mos me pranu që ka pasë qëllim armiqësor demonstrata e studentëve. Pse? Sepse efekti u arrit në kulminacion e tash osht' kryesorja ju me kalu me burg sa ma t'vogël.

Kur kemi hy na në gjykim aty, Osmani diti me inskenu ata, kishe u çum u përqaqum na te tan', kishe ishim mërzit. Osmani qaty ka thanë, "Hasan kurgjo armiqësore mos pranoni", kështu kadale. E tani ju kena përmbajtë qasaj gjatë krejt procesit. "Jo, jo s'kena pasë na qëllim armiqësor veç kemi kërku që edhe Kosova me pasë statusin e republikës së shtatë si republikat e tjera në kuadër të Federatës Jugosllave".

**Anita Susuri:** Po thoni edhe t'u pasë parasysh këta ndoshta ju kanë lehtësu [dënimin]?

**Hasan Dërmaku:** Po qysh jo. Se ata mos ta kishte pasë korigju Ismail Dumoshi atë referatin edhe mos na t'ishim shpreh që kena pasë qëllim kështu, kështu na bashkarisht ishim dënu me burgim ma t'randë. Po krejt këto merita e Ismail Dumoshit edhe në korigjimin e referatit po edhe ata që e ka çu nëpërmjet Qerim Gashit. Se Qerim Gashi ka qenë hetues i Osman Dumoshit. Këta duhet me pranu.

Osman Dumoshi tregojke kur shkum në kapedon në Nish tha, “Kur e jepsha deklaratën, e lexojshim ku e pajke që diçka ka elemente që të rëndojnë”, thojke, “jo po e prishim, tjetër fletë p’e bojna”. Vet Qerim Gashi shkojke në WC tinza e kallke letrën se jo me lëshu, e bojke shpuzë krejt e lëshojke aty edhe e lëshojke ujin. Ka qenë... edhe pse ka punu në sigurim ai ka qenë njeri fantastik, po.

E tash unë gjithë mendoj që nëpërmjet tina Ismail Dumoshi e ka njoftu atë e ai Osman Dumoshin që na gjatë procesit mos me pranë që demonstrata ka pasë karakter armiqësor. E qitash këto harrova këta. Për me lexu letren atë referat prej grupit të Osmanit ka qenë i caktun Osmani, prej grupit tim unë. Po kena pasë për detyrë m’i njoftu Osmani ni shok t’vetin, t’grupit t’vet unë njo t’grupit tim.

Unë e kom njoftu Skender Kastratin që ni letër, ni kopje e referatit e kom unë n’xhep, se nëse pengohet Osmani ose plagoset, vritet sikur Rudi Dutschke në Gjermani atëherë me vazhdu me lexu unë. Po kur kom qenë unë i pa aftë, unë thashë që as pesë-gjashtë minuta, dhetë minuta s’e maj mend. Tash Skender Kastrati e ka ditë që unë e kom kopjen n’xhep. Skender Kastrati ka ardhë e ka marrë kopjen prej xhepit tem edhe ka dalë te optika aty afër teatrit e ka lexu. E ka lexu ni pjesë Osman Dumoshi po ju ka marrë zani edhe e ka vazhdu letrën e ka lexu Skender Kastrati.

Kur kom shku me Shaip Berishën në Lepogllavë edhe aty këta policia e kapedonit të Nishit, e kishin marrë bukën ato konzerva me veti. Kur zhdrypëm prej kompanjollës së policisë, aty na rrethekun policia kroate e burgut. Dymbëdhjetë, 13 vetë e bonën si shpalir<sup>3</sup>. Kur zhdrypëm na lidhën me pranga, ai Shaipi ka qenë shumë, për vrasje ka qenë i ndjeri po shumë ka qenë trim i madh. Po i thotë ni polic i Nishit, “A p’e merrni bukën?” Ai u kthy ia shajti bukën, “Çetnikve”, tha, kshtu, kshtu ua bofsha bukën e çetnikëve.

Ata policia e Lepogllavës ma të civilizun ata s’ishin msu me ni kështu. Na morën na çun atje, na shtinën në dhomën e pranimit aty. Ndërkohë... e ata policët e Nishit kanë bujtë atë natë aty. E Zefi, Zef Kaçinari, se di, ka qenë kangë ajo që e ka vra kondukterin në Zagreb që ka qenë. Ai kishte qenë kuzhinier se qat’ profesion e ka pasë edhe në liri. I pytë ata policinë e Zagrebit, të Lepogllavës. “Çka janë këta?” “Këta”, tha, “Zef janë policë të shtëpisë ndëshkuese të Nishit po këtu i kanë pru”, thotë, “nja dy bashkëvendas tu po ishin t’rrezikshëm”. A din, se Shaipi i shajti.

Tash ishte veç ajo dhoma e pranimit ishte në atë manastirin e vjetër që sistemi jugosllav e kishte shndërru në pjesë t’burgut. U dashke me shku na çka ishim në dhomën e pranimit që u dufke me nejt nga ni muj ditë. Shkojshim me marrë atje bukën ku u bojke te kuzhina kryesore atje ku ishin pavijonet. Kur Zefi e porosit njënin thotë, “Qyre nesër le t’vjen ata që kanë ardhë prej Nishit”. Kur po na thojnë, “Hasan”, thotë, “çu Hasan. Ni kuzhinjer ka porosit me shku njani ju sot me marrë bukën”, se shkojshim me rend. “Hajt po shkoj une”.

<sup>3</sup> Është një formë ndëshkimi trupor që iu shqiptua ushtarëve dhe të burgosurëve për krime pak a shumë të rënda gjatë luftës. Në botën perëndimore, kjo metodë u ndalua në shekullin e 19-të.

Kur shkova po i thotë atina, “A qiky?” “Po”, po thotë, “Qita”, “Po”. Më mori ngryk. Kishim kontajnera, kishim kontajnera që me ble diçka-diçka. Kish pasë ble keks e ato krejt, sheqer e krejt. Kese, tinza na shtini ku e shtijnë bukën për të burgosur e shtini edhe ata për mu edhe për Shaipin. Se kur shkum atje na tri ditë veç keks se fyti ish ngushtu. Se na u bo dhetë ditë që s’hongrëm bukë s’mujshim me përbi bukën. Po me keks edhe me çaj e përsheshim aty edhe e hajshim. Zefi na ka shpëtu.

Këta tanë kohën Zef Kaçinari ka qenë shpëtim për neve dyve. Se kur vishin vëllezërit e mi në vizitë në Lepogllavë u kthejshin në Zagreb te vllavi i Zefit që ka pasë burektoren aty e lejshin kah pesë mijë denar. Ai që ka pasë kantinën, ai ish njoftu me atë vllavin e Zefit edhe me Zefin. Shkojke në Zagreb, ai i merrke pesë mijë denar pare kështu. A mu m’i dhante pesë mijë denar bona të kapedonit. Tana unë si me thanë si zotni jetojsa. Çka pagujshin aty që punojshim po edhe që i merrsha këto. Kështu që Zefi nonstop deri në ditën e fundit kurrë atij hakit s’muj i dalim.

Derisa ka vdekë para dy vjete gjithmonë kemi qenë mik shpije. Çka osht’ ma kryesori, kur jom martu unë masi jom dalë prej burgut e kom thirrë Zefin n’dasmë ka ardhë. Po çka osht’ ma kryesorja arriti mas 40 vjete me prit edhe kur u martu djali, edhe në dasmë të djalit ka qenë. Interesant.

**Anita Susuri:** E sa i përket vizitave që i përmende ma herët...

**Hasan Dërmaku:** Po.

**Anita Susuri:** Sa ka qenë vështirë për familjen me ardhë deri atje?

**Hasan Dërmaku:** Ka qenë vështirë. Lepogllavë unë t’thom t’vërtetën nana vike në dy-tre muaj po larg nana 70-80 vjeç. U dufke dy-tre autobusa m’i ndrru, në Zagreb, në Varazhdin. Ka pasë aty... i thojsha nanës, “Pse bre nanë po vjen? Mos u mundo”. Po se kisha pasë ditë çka osht’ djegia e evladit, kur u bonën fëmija mi atëherë e kuptova që s’ka mujtë pa ardhë e ngrata. Vishin.

**Anita Susuri:** Sa kanë zgjatë zakonisht?

**Hasan Dërmaku:** Tri vjet e gjysë atje, ni orë.

**Anita Susuri:** Ni orë?

**Hasan Dërmaku:** Niherë kam nejtë unë në grupën C. Aty e ke pasë 30 minuta si dënim. Ni vjet m’kanë majtë në grupën C vetëm vet me ni dhomë edhe s’kam pasë t’drejtë as me shku n’film askund, vetëm n’punë edhe n’dhomë. Aty e kom pasë 30 minuta vizitën. Masanej m’kanë qit’ në grupën B tana e kem pasë ni orë vizitën.

**Anita Susuri:** E qysh i kanë nda këto grupe?

**Hasan Dërmaku:** Po kanë qenë me koridore në pavijone. Se ai burgu kishte qenë katër krah te dy kraht banesa. 365 dhoma i ka pasë burgu kah tri metra gjatë ni metër e 20 gjon, po. I ka pasën 47 javë sa i ka viti a 50, qaq dhoma ma t'mdhaja. Dymbëdhjetë muj qaq dhoma ma t'mdhaja edhe ni bibliotekë që ka qenë ma e madhja. Ai Burgu i Lepogllavës ka qenë i marum në kohën e Maria Terezës kur ka qenë ajo mbretëreshë e Austro-Hungarisë.

**Anita Susuri:** A osht' maru për me qenë burg?

**Hasan Dërmaku:** Burg, burg, burg, burg. S'ka pasë aty.

**Anita Susuri:** Qysh ka qenë tani ma, a ka pasë ma dhunë fizike a dhunë psiqike?

**Hasan Dërmaku:** Jo, jo. Ti dhunën fizike, psiqike e kem pasë gjatë hetimeve a si të shkojsh në kapendon, jo, s'ke pasë. Vetëm nëse bon probleme t'çojnë në qeli t'çojnë në ato po jo.

**Anita Susuri:** E kur keni dalë prej burgut a keni dalë në datë të saktë?

**Hasan Dërmaku:** Po në datë të saktë. Une jom burgosë me 1 dhjetor po ishte festa, ata në Lepogllavë për mos me hupë me nejt ai kujdestar, ai bre edukatori që kom pasë unë. Ai më lëshoj mu me 31 dhjetor, a din. Shkaku që ai me shku dikund për festë, po. Erdh vllavi i madh atje m'ka pritë në Lepogllavë e tani bashkë kemi ardhë knena me autobus.

**Anita Susuri:** Qat' natë, domethonë, ni natë përpara që keni dalë a keni nejt dikund apo...

**Hasan Dërmaku:** Jo, jo kemi ardhë drejt në Zagreb në Zagreb kemi hypën në autobus e në Bujanovc kemi zbritë. Prej atyhit në Bujanovc te shpija.

**Anita Susuri:** Keni lajmëru ndoshta?

**Hasan Dërmaku:** Po, po, i kemi lajmëru.

**Anita Susuri:** Deshta me ju pytë, përmendet filma aty. E keni pasë kohën edhe kur është shiku filmi?

**Hasan Dërmaku:** Po. Në Lepogllavë atje çdo javë kemi pasë edhe film. Atje e kemi pasë sallën e filmit ka qenë veç. Aty s'ka pasë ndalime kemi pasë të drejtë gjithkush me shku n'filma aty. Bile m'kujtohet ka qenë java e filmit shqiptar. Tre filma janë dhanë, tri javë nga ni film. U dhante filmi, "I teti në Bronz". Ai m'kujtohet, qiky filmi.

**Anita Susuri:** A ka pasë shumë të burgosur politik shqiptarë aty?

**Hasan Dërmaku:** Jo, jo. Krejt kemi qenë shtatë-tetë vet shqiptarë krejt.

**Anita Susuri:** A ka pasë edhe të burgosur tjerë politik të vendeve tjera?

**Hasan Dërmaku:** Po ka qenë, kroatë ka pasë aty. Po, po, po ka pasë kroatë. Ka qenë ni, ky Vinko Knezheviq, ai ka qenë i dënun dy vjet e gjysë. Po tana dul ma herët, ai shkoj. Me atë jemi shoqnu. Ka qenë ni prift aty po ka qenë ni, ata e kishin pasë dënu si Stjepan Vegle. Ai kishte qenë me pikëpamje religjioze adventist. Unë e disha rëndësinë, a din, qysh e këto. Tana non stop ka nejt me mu.

Po ata e kanë dënu vetëm pse ka maru fabrikën e prodhimeve të pllantikës Sllavska Pozhegë. Tana e kanë dënu pse ke maru këta? Nanën e ka pasë hebreike, nana tij ka shku në Amerikë edhe kur ka shku ky ministër i financave të Jugosllavisë me lyp kredi atje. Ai lobi hebreit ka pasë fjalën kryesore, kjo e martune, nana e ktina, se i ka pasë dekë ktij Stepanit herët për ni jahudi se vet jahudi. E kanë blloku kanë thanë, “Jo, s’i japim kredi Jugosllavisë se ka marrë njerin pa faj”.

U ardhë ky në Jugosllavi edhe ktina Stjepan Vegles i ka ardhë me dalë në rigjykim. Nuk e kanë gjyku po ia kanë ba i ndërprehet dënimi. Ndërprerje e dënimit sa mos me thanë që me pranu dënimin. Po ai u lëshu. Si u lëshu kry ni javë dite e kanë qitën, kanë bo ndeshje e kanë mytë ata me gjithë gru. Ai ka lanë dy fëmi. Eduard edhe Alan i ka pasë fmija. E nana e vet vjen prej Amerikës m’i vorros këta dy. Ata i thojnë që, “Nanë, babi ka pasë ni shok shqiptar në Burg të Lepogllavës”. Nana e tij, plaka ma çon mu ni paketë edhe ni letër. Paketën ma dhanë a letrën s’ma kanë dhanë.

**Anita Susuri:** E çka ka pasë në paketë? Si...

**Hasan Dërmaku:** Po gjëra ushqimore, gjëra ushqimore.

**Anita Susuri:** A keni mujtë ma me rikontaktu?

**Hasan Dërmaku:** Me to jo. Se ai i ka marrë fmijen se kanë qenë 12-13, 13-14 vjet, i ka marrë meniherë në Amerikë ata. Janë shku në Amerikë. Po ai si u dalë ai Stjepan Vegle prej burgut meniherë ia ka çu vllavit tem Hasimit, ni letër me ardhë në Zagreb e kemi avokatin ma t’fortë me bo ni lutje me liru Hasanin ma së shpejti. Bile ai në bisedë e sipër thotë, “Ka pasë vizitë”, se gruja tina mu masi që atje u botua Kurani në gjuhën në kroate në ‘70-ten u përkthi. Tani gruja tina ma çoj në emër të vllavit Kuranin kroatisht. Biblën edhe jetën e Krishtit.

Unë i lexojsha. I di shumë këto çashtjet fetare. Ai kishte qef me m’bo adventist. Adventare simbas gjuhës latine, riardhja e Krishtit. Kur m’i murrë mu shënimet Hasan qysh tek e krejt ia kish pasë dhanë grusë t’vet Verës kur u ardhë n’vizitë. Kur po m’thotë mu i gzushëm, “Çka?” Thashë, “Pata sukses”,

“Çfarë sukcesi?” “Ja dhashë”, tha, “grujes biografinë tande e ti shkon tash si t’shkojsh n’shpi tash rri nja tre muj vjen në Zagreb në kishën adventiste e ki biografinë e ata t’ marrin të çojnë në Francë me kry kursin për adventist e me përhapë adventizmin nëpër botë”.

Po, “Mirë bre Vegle, po kush...” thashë, “Ata e financon Amerika”. Na atëherë ishim marksist-leninista, ishim kundër amerikanëve. Po çfarë po s’dojsha me ia prish qefin (qeshë). Qishtu ka qenë. Po valla.

**Anita Susuri:** E pastaj kur jeni kthi mas burgut si ju kanë prit në shpi? Si ka qenë?

**Hasan Dërmaku:** Po në shpi shumë mirë, shumë mirë po qysh jo.

**Anita Susuri:** A ju kthyt jetës ju?

**Hasan Dërmaku:** Po ju kthym jetës. Ata tjerë vllaznia kishin pasë përpari, kishin pasë ble traktor, kishin bo pasuri. Qe une për shembull s’kisha problem për... tana u martova. Në ‘73-ten me 29 korrik. Zefin e kom pasë n’dasmë aty edhe ata shoktë e burgut aty.

**Anita Susuri:** A ka qenë problem për shembull me gjetë nuse po thom për ni ish t’burgosun politik?

**Hasan Dërmaku:** Po. Po me atë ne gati se patëm fillu qysh para burgut. Po masi mbajta burg unë i pata çu fjalë që a din mos prit. Po jo ajo ka pritë edhe qishtu. Sot jemi me qat’ gru. Ajo rrobaqepëse është me profesion.

**Anita Susuri:** Pastaj ju aktivitetin e keni vazhdu?

**Hasan Dërmaku:** Po na, qyre, tana masi erdha këtu në konvikt aty, ndërkohë ke Kadri Osmani ish i burgosun politik. Erdh Xhafer Shatri. Xhafer Shatri e pruni ni hartim t’ni vajze të shkollës, në shkollë të mesme në vitin e katërt të gjimnazit. Emrin s’ia di Grajçevci mbiemrin. Po e lexon aty. E kishte pasë ni përmbajtje patriotike aty. Po i thom, “Xhafer, s’osht’ kjo interesant”, “Mirë”. E la qaty. Kur u shku ai, e ka lanë te unë. Unë s’e kom pa që ka mbetë te unë.

Kom shku n’shpi n’fund t’vitit edhe i kom marrë skriptat e mija krejt e jom shku n’shpi. Gjatë verës kanë ardhë sigurimi. U shkepën do afishe këtu në Prishtinë, janë shkepë. Xhafer Shatri e këta, grupi i ktyne, këta studentat e ri. E pat përfundu viti shkollor. Ata kanë dyshu që kom pjesëmarrës, jam pjesëmarrës në ato. Kanë ardhë në katun në Shipashnicë n’krye me, policia me Naip Hoxhën.

Kontrollun n’shpi edhe e gjetën qat’ hartimin. Ata e morën edhe më morën mu në burg në Gjilan. Unë e disha se kush e ka pru edhe kush e ka lanë te unë po s’e pranojsha. Thojsha, “Ne kemi pasë”, nime ni kusheri u martu e thojsha që, “dikush u ardhë natën e ka lanë me qëllim edhe ju ka lajmëru juve se ma

ka pasë inati”. Nejta katër muj në dënime më dënun me ni vjet për qata. Më lëshun në burg në liri. Se ka qenë atëherë ligji jugosllav deri në pesë vjet lëshojnë m’u mbrojtë në liri, mbi pesë vjet nuk t’lëshojnë.

Ende pa asi neve na burgosën për procesin e montun të ‘75-tes. Grupi me Adem Demaçin, Osman Dumoshin. Krejt neve na burgosën. Ky ka qenë proces thjesht i montun edhe kryesisht kundër Adem Demaçit, Metush Krasniqit edhe neve katër-pesë ‘68-tes se gjoja pshtum lehtë. Ajo ka qenë. A si pretekst n’atë kohë patën qit’ dy-tri here afishe grupet e studentëve. A kur kanë qit’ herën e parë Xhafer Shatri ka qenë.

M’thirri mu Xhafer Shatri n’banesë t’tina ka qenë nëpërmjet djalit t’vllavit tem Xhavitit m’u taku. Unë e disha që ai i ka qit’. Po m’thotë, “Çka po ta merr menja ty për këto afishe që janë shpërnda?” Unë t’u mos i dhanë atij që p’e di kush i ka qit’ e pse po qitni thashë, “S’di Xhafer”, thashë, “unë kom bisedu, kemi bisedu me Metush Krasniqin edhe çdo aksion që osht’ ma i vogël se demonstratat e ‘68-tes ka me pasë pasoja shumë t’randa a efekt zero”. Kshtu i pata thanë.

Po këta edhe niherë vazhdun edhe derisa erdh këtu... Titoja si thashë qatëherë në prill pak përpara. Ai dha urdhër që me qenë vigjilent kundër armikut të brendshëm. Tana n’atë kohë në Mal të Zi patën mbyll ni grup malazet a serb që u qujke në kry me Boshkoviqin, profesori i historisë në Fakultetin Filozofik ktu në Prishtinë. Ai u qujke Partia e Re. Kjo, po, Partia Komuniste e Re. Edhe ata i burgosën. E tash me na bo si barabar edhe na burgosën, po.

Aty jom mundu për këto shkrimet, qito, shënimet. Krejt me i dëshifru me emër për emër. Qito i kom pasë torturat ma t’mdhaja. Kom pasë tortura për Metush Krasniqin. Se me Metush Krasniqin na kemi shku te Adem Demaçi se Adem Demaçi banonte te Shkolla “Elena Gjika”, aty i ka pasë nja dy dhoma. Baba i atij Hetem Ramadanit. Aty ka banu Adem Demaçi. Me Metush Krasniqin dy herë kemi shku mas darke t’u mendu që kërkush s’po na sheh. Ata krejt e kishin pasë pa.

Folshim me Ademin po për çashtjet politike. Ademi, Adem Demaçi thojke, këta, Ademi edhe Metush Krasniqi asnjani ideologjikisht nuk kanë pajtu. Adem Demaçi thonte, “Derisa t’mos fiton revolucioni socialist në Amerikë edhe në Europë nuk ka, s’kem si shlirohemi”. Ndërsa, Metushi thojke, “Pa u forcu Shqipëria pak edhe pa na ndihmu Amerika, jo socialiste jo komuniste po kapitaliste, na s’mundemi m’u shliu”. E këtu neishim na kah tri-katër orë. Kur dilke Metush Krasniqi në WC mu m’thojke Baci Adem, “Hasan, kot e ke me këtë, kurrë s’mujna me bo marksist-leninist”. Ju dhimke që s’o marksist-leninist (qeshë). Qata.

‘76, ‘75 edhe ‘76 ka qenë totalisht për neve, për Ademin edhe Metushin. Që kanë dashtë edhe Metushin se Metushin unë kom shfletu, s’kanë pranu, se e dishin që edhe e kom pasë këshilltar gjatë demonstratave edhe kemi qenë te Ademi kemi bisedu edhe non stop jemi shoqëru po... a për Ademin njëni kish, aty, prej grupit tjetër që u dënu n’atë kohë ka deklarë që, ai ka deklarë për Ademin, s’du me hi n’atë anë. Tjetër kush ata le ta... po. A Metushin, po.

Tana ka pasë dy raste, ja ka qenë edhe Osmani në atë tubim te Skenderi, jo vllavi i tij tjetri i treti Shemsiu. Unë kom thanë, “Jo, ata asnjani s’kanë qenë”. U duftë diçka me pranë për me pshtu diçka tjetër ni t’madhe. Se e patën bo katastrofë shtëpijen e Skender Kastratit, vet edhe dy vllaznia.

**Anita Susuri:** Ju thatë që ju kanë izolu kur ka ardhë Titoja...

**Hasan Dërmaku:** Po, po. Kur ka ardhë Tita...

**Anita Susuri:** Kur ka qenë ajo?

**Hasan Dërmaku:** ‘74-ten, po ‘74-ten.

**Anita Susuri:** Veç disa ditë ka qenë?

**Hasan Dërmaku:** Pesë ditë nejta aty, po, qaty.

**Anita Susuri:** A pat’ aty naj...

**Hasan Dërmaku:** Jo, jo kurgjo. Bile kanë qenë t’u ma ndërto shpinë këtu në Prishtinë e Selim Brosha prej Gjilanit me ni shok m’kanë marrë prej ktuhit e m’i vun prangat. “Po s’po iki bre”, thashë, “Jo ma mirë t’jemi t’sigurt”. Këtu e në Ferizaj e në Gjilan. Pesë ditë nejta, mas pesë dite më lirun apert erdha te shpija.

**Anita Susuri:** ‘75-ten pastaj.

**Hasan Dërmaku:** ‘75-ten qiky grupi që thashë procesi i montun.

**Anita Susuri:** ‘75-ten pastaj qysh ka vazhdu?

**Hasan Dërmaku:** Ka vazhdu derisa na kanë... malltretime të hatashme.

**Anita Susuri:** Për sa kohë?

**Hasan Dërmaku:** Po për pesë-gjashtë, katër-pesë muj, po.

**Anita Susuri:** A ju gjykun pastaj?

**Hasan Dërmaku:** A?



**Anita Susuri:** A u gjykut pastaj?

**Hasan Dërmaku:** Po, u gjykum tana dolëm u gjykim. Tana u shpërndajtëm në kapedome. Mu m'çun në Idrizovë. Tana mas nja tri-katër vjete gjoja se me ni amnestion u lirova une. Tana erdhën te unë Metush Krasniqi e Sali Kryeziu, Tefik Geci. I tregova si u zhvillu procesi. Ky Metush Krasniqi edhe ky ka qenë si Osman Dumoshi shumë ka pasë lidhje në çdo shtresë të atëhershme të udhheqësisë edhe të popullit. “Po i dijmë”, tha, “krejt”, tha, “dashtë e pa dashtë ju keni qenë të gjykum. S’ka pasë fjalë, m’u gjyku edhe hiç”. Pse? Aty ka dhanë emër...

Qyre, të gjithë, neve na, neve formalisht na çojshin para gjyqit neve SUP-i na dënojke, SUP-i ta caktojke vjet sa me qenë, po. E masi kom dalë prej burgut erdh Metushi tha, “Dajko”, se e kom pasë Metushin edhe dajë babe, tha, “mos u sill kah fakulteti, mujsh me ndrru profesionin”. Tana unë shkova në degën e ndërtimtarisë drejtimin e hidros, i dhashë në Obiliq. E mora këtë titullin udhheqës i instalimit të ujësjellsit dhe kanalizimit. Kom punu në montazh të Kosovës gjatë aty kom punu. Po. Derisa na qitën prej punës atëherë.

### Pjesa e Katërt

**Anita Susuri:** E për m’u punësu a keni pasë problem?

**Hasan Dërmaku:** Po u dufke me shku me marrë për inkuadrim, po. Enti për inkuadrim që je i lajmërun aty. Unë s’kom qenë i lajmërum ka qenë ni Berisha i Matiçanit. T’ram prej Malësisë të Kamenicës atje. Ka qenë burrë i mirë. Vllavi e kish pasë njoftë atë. Thotë, “Le t’vijne se unë ia lëshoj fallc”, hiç edhe pse s’kom qenë. Tana më pranun këtu në montazhë si punëtor fizik. E tre-katër muj a gati ni vjet kom qelë kanalle punëtor fizik. Po ndërkohë e thashë provimin hidro-teknik në Obiliq edhe mësova projektin tana kom udhëheqë puntë nëpër objekte e kah mos.

**Anita Susuri:** Domethonë deri në vitin ‘90 keni punu?

**Hasan Dërmaku:** Po, po. Derisa na kanë qit’ prej pune. Tani me ni shok e blejtëm ni bager në Slloveni. Kemi punu 18 vjet ortak me atë shokun. Izet Rustolli prej Dumnicës të Vuçiternës privat kemi punu tani kom dalë në pension.

**Anita Susuri:** E në vitet e ‘80-ta që kanë qenë...

**Hasan Dërmaku:** E në ato vitet e ‘81-shes na me urdhër të Metush Krasniqit, se çdo gja jemi konsultu me ta. Bile Metushi ‘82-ten u zgjedhë kryetar i bashkimit, kur u bashkun grupet në Gjermani për me kërkë republikën shqiptare në Jugosllavi u zgjedh kryetar i atij grupi Metush Krasniqi, ka qenë në

Prishtinë. Na vijke gazetat “Zëri i Kosovës”, e çka u botojke në perëndim vijke aty. E me Metushin tana i marrshim i lexojshim.

Po Metushi ish në banesë këtu, m’i dhajke mu dikund m’i shti. Unë kisha oborrrin dhetë ari. Dikund m’i pshtjellë ato edhe m’i shti n’dhe nashta vjen koha najherë i botojmë te tonat si album. Po atëherë s’kemi ditë. Unë në najllon edhe n’dhe ajo lagështia shumë edhe janë prish s’di sa. Vetëm katër ekzemplarë kanë mbetë pa u prishë. Qata katër ekzemplarë ia kom dorëzu Selatin Novosellës. E sot janë në Bibliotekën “Adem Demaçi” që u themelu aty, po, qata katër ekzemplarë.

E ku osht’ te ‘81-shi as Metushi as unë s’kemi pasë gisht në organizim të tyne. Tana Metushi, Metush Krasniqi ka qenë ai... se unë për mu për shembull Ismail Dumoshi siç osht’ Gëte, Wolfgang Gëte për gjermanët që ka qenë demokrat në Gjermani edhe iluminist i popullit gjerman european qashtu ka qenë Ismail Dumoshi për Kosovën. Ka qenë me të vërtetë edhe demokrat po jo iluminist po ka qenë nacionalist. Pa, kombtarisht se nacionalisht jo me i urrejt kombet tjera. A Metush Krasniqi për Kosovë mu ma çon mallin si Bizmarku, m’i bashku po ky ka qenë ma... (qeshë), po, e qashtu.

A si... intelektual edhe patriot si Ismail Dumoshi... patriot edhe intelektual si Metush Krasniqi ka me shku shumë kohë s’ka me pasë rast me shëtite rrugëve të Prishtinës. Te dytë kanë qenë, secili në profesionin e vet, secili në atë, ka pasë... E ai vet Metush Krasniqi m’ka thanë, “Dajko, masi unë s’e kom ditë kush osht’ n’qeto, kush osht’ organizator s’mundët me ndodhë diçka në Kosovë pa qenë unë i njoftun”, thotë, “e rri larg”. E s’jemi përzi na.

Vetëm mas përfundimit të demonstratave, unë isha në Gjakovë në teren. Hydajet Hyseni kishte pasë qenë këtu ni kohë kishte pasë nejt ni kohë këtu në ilegalitet. Ndërkohë nëpërmjet dajës t’vet Sejdi Kryeziu lyp m’u taku me Metush Krasniqin edhe me mu. Vjen Sejdi Kryeziu i thotë shoqes teme me gjithë djalin e vllavit Xhavitin edhe ai që ka qenë n’burg i dënun politikisht m’lypin mu. Ajo Bahtia gruja jeme thotë, “Jo, ai osht’ n’teren. T’hanën ka shku deri t’shtunën nuk vjen”.

Po neve që na ndodhi ni havari, a kishte m’u bo pranimi teknik. Shtunën dhe të dillën s’na lanën me ardhë kena vonu edhe dy javë pa ardhë te shpija. Metushi ish taku me Hydën, po. A unë kur kom ardhën po m’thojnë këta Xhaviti erdh qishtu, “M’u taku”, tha, thashë, “Ani bre s’ka problem”. Kur mas dy dite u burgos Hyda e s’kom pasë mundësi m’u taku.

Ka qenën këtu ni Ismail Maliqi officer ushtarak në Ushtrinë Jugosllave, po aktivist në, aktivist i mirë në Organizatën e Lidhjes Komuniste mrena ushtirisë. Ai kishte pasë ra n’kontakt, nuk e di se qysh, me Ismail Dumoshin. Po Ismail Dumoshi qaq ka qenë si magnet, a din, dhe i ka pëlqy Ismail Maliqit, ai n’uniformë, qaq tepër sa ish mahnit Ismail Maliqi.

E kur shkon Ismail Maliqi ka pasë motrën prej Hogoshtit, motrën e ktina Ahmet, këtij bre, Sylejman Ahmetit që thashë që kemi shtypë afishet në shtëpi të tij. Shkon në Hogosht te familja, te kusherit e

shoqes. A Metush Krasniqi i ka pasë dajtë Ahmetovit në Hogosht. Aty takohet Metush Krasniqi edhe ky oficeri Ismail Maliqi. Këta zhvillojnë bisedë e në bisedë e sipër i tregon për Ismail Dumoshin ky Maliqi që ka nejt Metushi edhe i tregon që, “Jom mahnit, qysh osht’ ai njeri kaq i zoti”.

Ia shpjegon Metushi krejt biografinë e Ismailit edhe mirren vesh. Ky Maliqi thotë Metush Krasniqit thotë, “Metush nëse unë marr vesh nëpërmjet organeve partiake në ushtri që po përgaditet burgosja e një njerit të rëndësishëm në Kosovë apo të ndonjë grupi të njoftoj ty edhe Ismail Dumoshin. E ju duhni me ia bo qaren m’i qitën jashtë, m’i largu”.

Atëherë Metush Krasniqi vjen m’thotë mu, “Qysh e ki punën me Zef Kaçinarin?” A Zef Kaçinari, vllavi i Zef Kaçinarit edhe familja Kaçinari e kanë pasë qit’ jashtë, këtë bre, ia kom harru emrin, e qujshin Emiljo Kastrioti prej Vuçiternës, ata kanë qit’ ni t’burgosur politik prej Zagrebit ata me paret e veta e kanë qit’ jashtë. Thashë, “Ti Baca Metush mos ki gajle”.

Tana e pata marrë unë, për shembull, nëse duhet dikond me qit’ me çu deri në Zagreb me ia dorëzu familjes Kaçinari ata me qit’ jashtë. A Metush Krasniqi në rast nevoje me çu deri në Sarajevë me dorëzu te Hil Lleshi. Metush Krasniqi ka qenë atëherë i mobilizun si anëtarë i Rinisë Komuniste Jugosllave. Ata serbisht e qujshin SKOJ<sup>4</sup> a din. E këto kur shkun e çojnë në Prizren në Prizren e caktojnë me qenë në koridor ku kanë qenë t’burgosun Nue Përlleshi e Marie Shllaku, Bernadin Llupi, prifti i Pejës e kështu ata tjetër.

Aty ndërkohë ky fillon bisedat me Marie Shllakun, siç thashë ma parë. Ky insiston del nëpër fshatrat kur ka pasë pushim me lyp njerëz kush ka mundësi me ardhë m’u bo dhjetë veta a sa t’bohen që Marie Shllakun unë e nxjeri prej burgut kur jom ndrrim, unë e lëshoj prej burgut. Po s’ka mujtë me gjetë asi njerëz, nga frika e madhe. Po ka pasë autoritet Metush Krasniqi në fshatrat e besimit katolik edhe në Prizren edhe në Zagreb që janë shpërngul.

Ky Hil Përlleshi që ka jetu në Sarajevë, u shpërngulë prej Kosovës edhe ka pasë lidhje u njoftu sa ka qenë në burg Metushi, sa ka qenë t’burgosur aty Marie Shllaku ky Ndue Përlleshi qaty janë njoftu me Hil Përlleshin edhe ka pasë shoqni prej këtu në Sarajevë.

**Anita Susuri:** Po du pak m’u kthy te arrestimi i ‘75-tes kur keni qenë në Idrizovë?

**Hasan Dërmaku:** Po.

**Anita Susuri:** Si ka qenë atëherë?

---

<sup>4</sup> SKOJ u themelua në Zagreb më 10 tetor 1919 si një organizatë politike e rinisë revolucionare, e cila ndoqi politikën e Partisë Socialiste Punëtore Komuniste të Jugosllavisë.

**Hasan Dërmaku:** Atje ka qenë, aty ka qenë në Idrizovë ka qenë Rexhep Mala, Njazi Korça edhe grupi tjetër që u dënuar n'qat' kohë, Ajet Rukiqi. Po Ajet Rukiqi ishte lëshu ma herët. Po kishte qenë edhe do që janë tetovar. Rafiu ka qenë me grupin e vet. Elmazi, Rafiu aty kish qenë në Tetovë. Aty jemi shoqnu. Po unë ia pata detyru vetit m'u sjellë sa ma mirë, u bona si, po... vetëm e vetëm me dalë sa ma herët e me ikë me dalë n'përdim edhe m'u drejtu që krejt janë pa faj, pa faj pjesa ma e madhe.

A këta ni pjesë kanë shkepë afishe po s'e pranojshin këta, dorën n'zemër. A kanë shkepë se i di ata. Po kur dola ata e panë që s'më interesonte. Po ndërkohë i prunën do për ngatërresa prej Kosovës aty. Ata lypshin me zor me ardhë m'i kthy kha në Prishtinë. Në Kosovë atëherë s'ka pasë shtëpi ndëshkimore sikur tash që është te Istogu atje te Dubrava. Ata bonën problem i çun në qeli. U kapen me polici. Ata maqedont të pa shpirt, kurgjo s'janë serbët çka janë maqedonët në raport me shqiptarët. Se fundrrina e sllavizmit janë maqedonët.

Atëherë tana qaq i malltretun njëni ish për përdhunim me t'thanë të drejtën a njani për vrasje. Qata për vrasje thuhet se kta prej jashtit e kanë organizu që diqysh, po. Tana ata dy i mytën në kapendon. Po me ç'fajësu vetën dojshin me lidh me Rexhep Malën dhe Njazi Korçën. Po unë e porosita në vizitë vllavin që me shku te vllavi i Rexhep Malës me ardhë me më marrë mu dëshmitar që s'osht' e vërtetë që këta kanë pasë lidhje me ata. Se u frikësojsa që mos po i qesin. Po këta s'e bonën ni gja të tillë vetëm e morën Njazin edhe Rexhepin i transferun prej atyhit. Tani mbeta prej kosovarëve vetëm unë aty me ata tetovarët me Rafi Alilin e Elmaz Elamzin e kanë qenë edhe do tjerë.

**Anita Susuri:** Domethonë këta që i paskan vra, që i kanë myt në burg nuk kanë qenë për...

**Hasan Dërmaku:** Jo, jo s'kanë qenë.

**Anita Susuri:** E qysh kanë dashtë me lidh me...

**Hasan Dërmaku:** Po për me shfajësu drejtoria ata policia vetën, gjoja se janë lidh me t'burgosur politik këta po i shtijnë a që lidhje s'kishin hiç.

**Anita Susuri:** Domethonë sa keni qenë ju n'burg paska ndodhë qajo...

**Hasan Dërmaku:** Po, po, po. Njo ka qenë prej Deçanit, komunës së Deçanit e njo ka qenë qitu kah Dobraja e Madhe qitu po.

**Anita Susuri:** E vitet e tjera tash në krahasim me vitet në burg që keni qenë ma herët qysh ka qenë ky burgu knej? A keni pasë edhe aty naj aktivitete a diçka?

**Hasan Dërmaku:** Jo s'kom pasë aktivitet. Masi kom dalë prej atuhit vetëm kom punu. Me Metushin e kemi, me Metush Krasniqin me Sejdi Kryezinë kemi përcjellë gjendjen, a din, pak a shumë politika si po

zhvillohet po. Se Metushi n'qat' kohë e pat' punu shpijen këtu në Dragodan e unë pata marrë veç sa me qenë me to kishe po punoj me bisedu, e punojsha ujësjellsin e kanalizmin te ai. Ka dy muj ka zgjatë ai, vetëm për atë.

E prej atyhit tani i merrsha gazetata, prej Metushit, i shtisha nifar' thesi ka pasë aty na dhojke me pasul se ai gjejke pasul shumë e qaty i mshefke. E prej atyhit i çojsha te shpija jeme i shtisha n'dhe ato. Po ato mjerisht shumë ekzemplarë si prej anës së poshtme si naltë kanë dekompozu se prej lagshtisë. Vetëm këta në mes që kanë qenë nja tre-katër ekzemplarë. Tana i pruna në Shoqatë te të Burgosurve Politik e i murr Selatini i ka shti në bibliotekë aty.

Tana masanej që mos me pasë na aktivitet Metushin e morën në '85-ten e burgosën. Prej torturave t'mdhaja, prej torturave t'mdhaja ai vdiq. '86-ten e lëshun. Ata e lëshun Metushin sa mos me dekë në burg se ai s'ka pasë ma jetë. Bile kur kom shku n'vizitë edhe te shpia me vizitu shkojsha shpesh. Djali i vet Mithati ka qenë mjek. Po i thom, "Mithat, qysh po ta merr menja?" "Jo", tha, "ditët i ka të numrune baba jem". Ai vdiq me 15 tetor '86-ten. Ismail Dumoshi u smu prej kancerit vdiq '88-ten.

Po qat' vjet Ismail Maliqi oficeri e hetun ata që osht' po punon për çashtje kombëtare edhe t'u shku ka qenë në pushim këtu në Kosovë. T'u shku për atje për Beograd ia kanë qit' shleper e kanë myt me gjithë gru, Ismail Maliqin aty edhe ni djalë m'duket. A kur ka dhanë radio qat' ditë lajmin që u myt në fatkeqësi gjoja se të komunikacionit Ismail Maliqi tre oficer të Gjilanit kanë qenë në Hotel "Kristal" aty. Ni dajë i jemi ka punu në Binaçka Moravë ka qenë me shpinë me kta afër. "Ata te tret", tha, "u gzun. Bile porositën edhe ni pije. Me ner' me thanë, 'Shkoj ni mut i madh', u gzun", tha.

**Anita Susuri:** E ju t'u i pa krejt këto ngjarje, këto që kanë ndodhë plus edhe u acaru edhe ma shumë ngjarja politike, çka ka qenë domethonë vendimi i juj? Gjendja juj në ato kohë?

**Hasan Dërmaku:** Po në ato kohë, në ato kohë, kqyre, se në atë kohë kur fillun këto shkatërimi i Jugosllavisë, se qata dashta me përmend. Ni Dragan Simiq e ka shkru ni libër "Titoja fenomen i shekullit". Në atë libër shkrun, përveç tjerash, ministri i punëve të brendshme të Jugosllavisë në atë kohë Lupçe Samonikovo, maqedon, se ka qenë me rrotacion me ardhë.

Kur e lajmëron, kur shkon e lajmëron, raporton te Tita për situatën e sigurisë në Jugosllavi 1971-ten deklaron edhe thotë se për demonstratat e '68-tes në Prishtinë të studentëve e kanë ditë jo vetëm studentët po e kanë ditë edhe Këshilli Komunal i Prishtinës edhe Këshilli Krahinor. Po kurgjo s'kanë marrë deri n'momentet e fundit. Qashtu osht'. Po krejt kanë qenë aftësia e Ismail Dumoshit me shoktë e vet t'u organizu.

Tash nuk p'e di nashta ka pasë edhe me funksionar t'lartë të Komitetit Krahinor po me disa po. Këta e shkrun ai Simiq, ai që shkrun libër për Titon. A Raif Dizdareviqi shkrun thotë, me ngjarjet e '68-tes në Jugosllavi, në Prishtinë Kosovë, u ditë që Jugosllavia ka me u shkatërru...

**Anita Susuri:** Prej '68-tes.

**Hasan Dërmaku:** Po, po. “E kemi pasë krejt të kuartë, *Bilo je nama sve jasno*, e kemi pasë të kuartë që Jugosllavia ka me u shkatërru”. Kur filloj tash m’u shkatërru Jugosllavia prej Sllovenisë... Serbia s’ka qenë për Slloveni, e ka pasë, Serbia e ka pasë Kroacijen e në jug te poshtë. E atëherë kur filloj në Kroaci ky ka qenë profesor i shkollës së mesme ushtarake, Anton Berisha në Zagreb. Ai në lidhje me kta kroatët, me Tuchman edhe çojnë lajme që në Ferizaj, që në Kosovë me hapë frontin e jugut.

A për neve ka qenë vdekje. Se me leju Tuchman m’u liru presioni i Serbisë e Serbia m’u angazhu ma tepër për Kosovë. Vijnë... unë punojsha në Ferizaj ujësjellës e kanalizim. Vijnë tre vet prej Ferizajit n’krye me Rexhep Ismanin qishtu, qishtu na ka ardhë lajmi prej Zagrebit. Thashë, “Po gaboni, ky lajm osht’ tragjik për Kosovën”, thashë, “shkoni se vi të dillën”. Shkova aty u shpjegova ku qysh tek edhe nuk lëvizën. Se t’fillojshin qat’ kohë sa ishte lufta në Kroaci me fillu te na frontin e jugut, na ishim shkatërru. Pse? Ktu ka qenë niherë politika e perëndimit m’i shkatërru sllavët në mes veti si vllazën. E na kemi qenë si ni jetim, ni nip jetim m’u nda.

E kur ka fillu ktu te na lufta në Kosovë ktu s’kom marrë pjesë në UÇK se i kom pasë do vjet. Bile Isa Kastrati masi u vra Doktor Leci, Isa Kastrati në Matiqan e mur familjen Lecit. Unë shkova për ngushëlime te familja e Lecit e nejta sa nejtëm. Dolëm kah ora 10:00 me ni dhomë t’vogël e po thotë Isa Kastrati, “Hasan”, thotë, “e kom vendosë me dalë në UÇK”, po thom “Isa Kastrati, ty familjarisht”, se mixhollarët e tyne njo ju ka vra në ‘46-ten ‘47-ten ni mixh, dy i ka pasë n’burg përpara, “ti si student kurrë s’të kanë lanë rahat. Ju si familje jeni UÇK prej ‘47-tes. Mos le”, se edhe fmitë i ka pasë ma së keqi prej krejtve katër fmi krejt prush. “Rri në logjistikë ma tepër kontribon”, “Ani tha”. Deri në ora 02:00 kena bisedu.

Prej aty më përcolli mu. Unë isha në Lagjen e Spitalit. Tha, “Bisedojmë edhe niherë”. Mas dy dite e prun ni gru t’kusherinit kishte pasë sulm në kokë. Isha nja katër-pesë ditë t’u e bajtë në spital. Vdiq në spital e çum na për Shipashnicë. Patjetër me çu unë edhe me nejt pak nja katër ditë ngushëllimi. Kur erdha Isa Kastrati kishte dalë në mal. E disha që... edhe si ka dal Isa Kastrati në mal Muharrem Pllanës, mikut të Isa Kastratit i kom thanë, “Zoti t’lashtë shnosh se trimërinë që ka Isa Kastrati ai i gjallë nuk kthehet n’shpi”, edhe qashtu i ndodhi. Po.

Sa kemi qenë ktu na, unë Abdurrahim Kelmendi, Miki i Isa Kastratit, Muharrem Pllana. Kjo bre, ni mjeke ka qenë, ia harrova emrin. Aty kemi gjetë pak t’holla pak ilaçe e i kanë çu ata. Ia kanë dorëzu Fehmi Lladrovci. E ky, ky bre, Muharrem Pllana ish prej asaj ane përte Sibovci atje ma ka pasë kontakt me të.

E i pata thanë Muharrem Pllanës, “Muharrem Pllana dije se tri lloj lufta zhvillohen sot n’botë. Lufta gurile, frontale, gurile edhe fetakombli. Lufta frontale, na s’kemi fuqi në mënyrë frontale me luftu me

Serbinë. Luftë gurile nuk jemi vend si Vietnami përskej detit kurrë mos me pasë borë e dimër. Kur vjen dimri te na kah kanë me shku ushtarët, duhet kta me llogaritë. Luftë fetakombi që e boni Izraeli në '67-ten kundër vendeve arabe edhe ata s'mujna me bo na po duhet me pasë parasysh kta lufta guerile po gjithë me pasë parasysh kur vjen stina e dimrit kah me...”, po.

Po qita ia ka përcjellë atyne. Qita ia kom thanë edhe Isa Kastratit. Bile Isa Kastrati tha, “Po dal që me tërhjekë frontin edhe kah komuna e Kamenicës”. Kjo është në hartën gjeo strategjike ushtarake. Kur Serbia humb në luftë ajo tërhiqet kah veriu. Po nëse në Grykën e Dërlicës atje në Serbi bombardohet mbyllet ajo udhë, atëherë udha alternative është Shkup, Bujanovc, Srep, Kamenicë, Tuxhevc edhe hin në Serbi. Kjo ka qenë rruga alternative ushtarake osht' e njoftne. Kta kanë tentu se unë gjatë luftës kom qenë n'katund kom ikë se Lagjen e Spitalit e shprazen krejt. Unë me djalin. A shoqja me dy vajzat u shku në Maqedoni ka nejt. E kshtu veç çka kom dhanë udhëzime a pjesë nuk kom marrë.

**Anita Susuri:** E kur ka qenë... prej ditës që kanë fillu bombardimet ju jeni largu a ma herët?

**Hasan Dërmaku:** Ja, kur kanë fillu bombardimet me 28-tin mars. Me 01 prill morëm vesh se, se familja erdh... gruja ime ka qenë prej unazave, gërrbaft ka shku. Ka ardhë te djali vllavit ktu në Dragodan, në Lakrishtë. E tana prunën vendimin krejt m'i qit' prej atyhit. I kanë marrë i kanë qit' i kanë çu për Maqedoni. Janë strehu ni katund rrethi i Gostivarit atje. Kanë kalu sikur me i pasë pasë ata prind edhe sot e asaj ditë ne shkojmë e vijmë me atë familje.

Unë me djalin, djali i ka pasë 16 vjet mbetëm ktu. Hinëm në ni podrum e maskum me dru me ata ni podrum te vllau. Po thanë që ka thanë ushtria që duhet m'u largu krejt këtë lagje me lshu. Tanaj jemi shku na ktu, unë, vllavi, unë me djalin, vllavi i katërt ai, Njazia ni kusheri edhe ni djalë i tina. Ai ishte ma i madh djali i tina. Ktu e kah Novoberda atje kemi kalu. Ni natë kemi kalu në Marevc në shkollë të Marevcit kemi fjet, ni natë në Krilevë te do teze. Ni natë kemi fjet te do daj në Gmicë e tani kemi mrrri në fshat në Shipashnicë.

Aty në fshat na kanë prit jashtë mirë ata kusherit e krejt bashkëfshatarët. Sidomos vlen m'u përmend ktu kur jom nisë, unë pare atëherë ke nal puna. Po qiky shoku Abdurrahmon Kelmendi m'i pat' dhanë mu 750 mark, “Le t'gjinden n'xhep”. Me qato marka unë e kom kalu... s'kishe nevojë po kryesore m'u kanë gjind qato që m'i ka dhanë Abdurrahim Kelmendi, 750 mark. A ndihmën ma t'madhe ma kanë dhanë kusherit si Sudollahi, Nebihu gjithë fshatarët. Çdo kund kemi pasë ni darkë, ni sillë krejt jemi end.

A ka qenë ni penzioner i Zvicrës, ni Ali Veli Dërmaku, ai kishte pasë pare shumë. Kur u... u tutke jo po vijnë policia, jo s'po vijnë. Ai tha, “Kqyre Can”, tha, “unë i kom 100 mijë franga t'palune te shqipja. Habimin edhe këtë kusherinin kërkush s'i njuh ktu, po ti masi je, ke qenë i burgosur politik ndoshta kanë shënime me ardhë me rretheku katunin ty t'marrin, po ti për pare mos e le. Qe pare sa t'dush, gjej

njerëz me t'qit deri në kufi të Maqedonisë". Ai ka tregu shumë mirë. A djali i tij Shabiu ka qenë i dënun politikisht si ushtarak në procesin e Sarajevës, po.

Ai, ky, Ali Veli Dërmaku tha, po i thashë, "Unë baci Ali qe ni muj e gjysë jom nëpër kusheri te ju krejt, me bo me ardhë ata me m'lypë mu s'osht', 'Po a ka qenë te ju?' 'Po', 'Ku osht'? Kta i malltretojnë. Ma mirë po flijohna për krejt kta se me ma pa sherrin kta". Megjithëse ai tha, "Për pare mos e le", tha, "sa t'dush. Tani m'i kthy".

**Anita Susuri:** E n'fshat a ka pasë diçka?

**Hasan Dërmaku:** Jo, jo. Erdhën m'i bo do regjistrime kush sa kanë mbetë. Po ato i bonën gjysë dite e shkun a s'janë kthy se e panë që u nënshkru marrëveshja e Kumanovës, e kshtu.

**Anita Susuri:** E ku jeni kthy ju...

**Hasan Dërmaku:** A kur kanë hy ushtria, po, në do shpija po do kanë bo... se i kanë pa prej kodrës janë hi nëpër oborre t'u e mshef dukatin e grave lira a din. Si kanë ardhë, "Qiti", "Jo s'kem", i kanë rreh kah pak edhe ju kanë marrë qata i kanë plaqkit.

**Anita Susuri:** E kur jeni kthy në Prishtinë në banesë te ju...

**Hasan Dërmaku:** Shpi kemi pasë. Qysh ka qenë, se vllau i dytë mbet me gjithë gru. Ai tha, "Unë po bohna kurban e s'e lshoj ktu m'u bo çka dojnë". Ai kur erdh po ish mush bari si shkret ish bo krejt. Tana kur u ardhë gruja ktu mas ni javë dite u bo operacion te Telal Gjinolli ktu prej unazave.

**Anita Susuri:** Qyteti qysh ka qenë?

**Hasan Dërmaku:** Qyteti ka qenë... po gzim ka qenë, gzim ka qenë.

**Anita Susuri:** Po mendoj kshtu damet materialet?

**Hasan Dërmaku:** Damet jo, ktu ka qenë bombardimi i sekretariatit e qito ktu po a ktu mrena n'qytet jo s'ka pasë.

**Anita Susuri:** Deshta edhe pak m'u kthy te vitet e '90-ta që thatë na kanë qit' prej punës atëherë...

**Hasan Dërmaku:** Po.

**Anita Susuri:** Qysh ka ndodhë qajo ditë?



**Hasan Dërmaku:** Po erdh ato, po ke kryetari i sindikatës Hajrullah Gorani e organizoj me 03 shtator mos me punu as ni shqiptar mos me shku n'punë. Kta mezi pritën si pretekst. Krejtve na qitën prej punës. Aty ishte ni, pak a shumë, s'di pse u bo qajo qashtu po... se tani ata i prunën njerëzit e vet. Po. Çdo kapital që e lishim nëpër firma gypa e qito krejt i merrshin ata i çojshin nëpër Serbi a kah i çojshin... po janë detyru. Kur u kthym tana ma s'kishe çka me punu aty. Po e marrë montazhën se tjerat s'e di, po i njeiti rast ka ndodhë. Kur u kthym s'u kthyn nja pesë-gjashtë vet s'kanë pasë çka me punu se ende s'u çelë puna që me punu, qishtu.

**Anita Susuri:** Pastaj ju vet e keni...

**Hasan Dërmaku:** Po vet.

**Anita Susuri:** Deri në cilin vit jeni penzionu?

**Hasan Dërmaku:** Deri 2007-ten qishtu.

**Anita Susuri:** 2007-ten po. Mirë, zoti Hasan nëse doni për fund diçka me shtu nëse keni harru diçka me thanë ose doni me cekë.

**Hasan Dërmaku:** Jo për momentin kurgjo. Mendoj që i kom përfshi, s'paku 95% i kom përfshi të gjitha. Diçka harron njeri po s'osht'... me qenë qaq me randësi s'e kisha harru po diçka ndoshta ndonjë imtësi ka mbetë. E shoh që situata për ne shqiptarët kurrë ma mirë s'ka qenë. Do e bojnë kijamet, do asi. Po për neve osht' shumë mirë kush e kupton politikën.

Dertin e inatin ma t'madh e kom tek ne mos pajtimi i partive politike te na, kjo më shqetëson. Jo për tjetër, qysh po dijnë kshtu kaq prap, vetëm xheloz. E bon ky kta, unë s'pranoj. Pa marrë parasysh a osht' interesi i Kosovës a nuk osht'. Qata pak a shumë. Po më nervozon, po më shqetëson, po më qet prej taktit. Se a e ke pa kur ni njeri prej 20 e tërë jetën ia ke kushtu jetën krejt e tash m'u shty për pozita e ato, s'ka.

**Anita Susuri:** Zoti Hasan, faleminderit shumë për intervistën edhe kohën!

**Hasan Dërmaku:** S'ka përse edhe juve ju uroj sukses edhe për intervista tjera. E zoti ju dhashtë ndihmë e buxhet se pa pasë buxhet edhe ndihmë s'keni (qeshë).